



**KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT ITALIAN DHE ATIJ SHQIPTAR  
MBI INSTITUTIN E TRASHËGIMISË**

TEZA E MASTERIT

DEA MEÇA

EPOKA UNIVERSITY

FACULTY OF LAW AND SOCIAL SCIENCES

DEPARTMENT OF LAW

TIRANA, ALBANIA

QERSHOR 2023

**KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT ITALIAN DHE ATIJ SHQIPTAR  
MBI INSTITUTIN E TRASHEGIMISË**

DEA MEÇA

Teza e dorëzuar për plotësimin e kërkesës për titullin Master i Shkencave Juridike në  
Drejtësi

EPOKA UNIVERSITY

QERSHOR  
2023

## APPROVAL PAGE

**Student Name & Surname:** Dea Meça  
**Faculty:** Faculty of Law and Social Sciences  
**Department :** Department of Law  
**Thesis Title :** Krahasimi i legjislacionit italian dhe atij shqiptar mbi institutin e trashëgimisë.  
Comparison of italian and albanian legislation on the institution of inheritance.  
**Date of Defense:** 10.07.2023

I certify that this final work satisfies all the legal requirements as a Master Thesis for the degree of Master of Science in Law.

Dr. Niuton MULLETI  
**Head of Department**

This is to certify that I have read this final work and that in my opinion it is fully adequate, in scope and quality, as a Master Thesis for the degree of Master of Science in Law.

Dr. Gelande SHKURTAJ  
**Supervisor**

### Examination Committee Members

Title / Name & Surname	Affiliation	Signature
1- Dr. Gelande SHKURTAJ	EPOKA University	
2- Dr. Ada GÜVEN	EPOKA University	
3- Dr. Eglantina FARRUKU	EPOKA University	

# KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT ITALIAN DHE ATIJ SHQIPTAR MBI INSTITUTIN E TRASHGIMISË

## ABSTRAKT

Ky studim do të trajtojë krahasimin e legjislacionit italian dhe shqiptar mbi institutin e trashëgimië. Instituti i trashëgimisë është një nga aspektet kryesore të ligjit të trashëgimisë dhe është thelbësor në shpërndarjen e pasurive të një personi pas vdekjes së tij. Kjo temë synon të analizojë dhe krahasojë legjislacionin italian dhe shqiptar në lidhje me institutin e trashëgimisë, duke u përqendruar në parimet themelore të ligjit të trashëgimisë, siç janë lindja e trashëgimisë, përcaktimi i trashëgimtarëve, detyrimet e trashëgimtarëve dhe procedurat e ndjekjes së trashëgimisë. Në krahasim me legjislacionin italian, legjislacioni shqiptar mbi institutin e trashëgimisë ka ndryshime thelbësore, siç janë rregullat e kalimit të pasurisë, kufizimet dhe detyrimet e trashëgimtarëve dhe procedurat e çeljes dhe vendimit të trashëgimisë ligjore.

Një analizë e detajuar e legjislacionit italian dhe shqiptar në lidhje me institutin e trashëgimisë mund të ndihmojë në identifikimin e ndryshimeve dhe ngjashmërive midis tyre dhe në vlerësimin e efektivitetit të legjislacionit në ndarjen e pasurisë dhe të drejtat e detyrimet trashëgimtarëve.

Në përfundim, kjo temë synon të sjellë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit shqiptar, kur evidetohen epërsi mbi institutin e trashëgimisë në krahasim me atë italian.

**Fjalë kyce:** *trashëgimi, trashëgimlënës, trashëgimtarë, testament, legjislacion, pasuri.*

# COMPARISON OF ITALIAN AND ALBANIAN LEGISLATION ON THE INSTITUTION OF INHERITANCE

## ABSTRACT

This study will deal with the comparison of Italian and Albanian legislation on the institution of inheritance. The institution of inheritance is one of the main aspects of inheritance law and is essential in the distribution of a person's assets after his death. This topic aims to analyze and compare the Italian and Albanian legislation regarding the institution of inheritance, focusing on the basic principles of inheritance law, such as the birth of inheritance, the determination of heirs, the obligations of heirs and the procedures for pursuing inheritance. In comparison to the Italian legislation, the Albanian legislation on the institution of inheritance has essential changes, such as the rules of the transfer of property, the limitations and obligations of the heirs and the procedures for the initiation and decision of the legal inheritance.

A detailed analysis of the Italian and Albanian legislation regarding the institution of inheritance can help to identify the differences and similarities between them and to evaluate the effectiveness of the legislation in the division of property and the rights and obligations of the heirs.

In conclusion, this topic aims to bring recommendations for the improvement of the Albanian legislation, when superiority over the institute of heritage is evidenced compared to the Italian one.

**Keywords:** inheritance, testator, heirs, will, legislation, property.

## MIRËNJOHJE

Së pari dhe më e rëndësishmja, do të doja të falënderoja nga zemra udhëheqësen time të tezës, Gelanda Shkurtaj, për udhëzimet e paçmuara, mbështetjen e palëkundur dhe këshillat, jo vetëm në formësimin e kësaj teze, por gjatë gjithë këtij rrugëtimi 5 vjeçar. Unë jam vërtet mirënjohëse për mentorimin dhe njohuritë që kam fituar nën mbikëqyrjen tuaj.

Dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohje për familjen time, për mbështetjen dhe besimin që më keni falur.

Dua të falënderoj pafund dhe miqtë e mi të cilët i bënë kaq të bukura dhe të paharrueshme këto vite të universitetit.

Faleminderit !

## **DEKLARATA**

Deklaroj se ky Projekt i Diplomimit, i titulluar “Krahasimi i legjislacionit italian dhe atij shqiptar mbi institutin e trashëgimisë”, bazohet në veprën time origjinale, përveç citimeve të cilat janë pranuar siç duhet. Gjithashtu deklaroj se kjo tezë nuk është dorëzuar më parë apo njëkohësisht për dhënien e asnjë diplome, në Universitetin Epoka, në ndonjë universitet apo institucion tjetër.

Dea Meça

Data: Qershor 2023

## TABELA E PËRMBAJTJES

FAQJA E MIRATIMIT .....	i
ABSTRAKT .....	ii
ABSTRACT .....	iii
MIRËNJOHJE .....	iv
DEKLARATA.....	v
HYRJE.....	viii
KAPITULLI I.....	1
KONCEPTET KRYESORE.....	1
1.1. Koncepti mbi testamentin.....	1
1.2. Koncepti mbi institutin e trashëgimisë .....	4
1.3. E drejta për të lënë testament.....	6
KAPITULLI II.....	10
RREGULLIMI I INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR.....	10
2.1. Historiku i krijimit të institutit të trashëgimisë në Republikën e Shqipërisë.....	10
2.2. Rregullimi ligjor i institutit të trashëgimisë sipas legjislacionit shqiptar .....	14
2.3. Trashëgimia ligjore, të drejtat dhe detyrimet që lindin si pasojë e trashëgimisë.....	19
2.4. Trashëgimia testamentare, koha, vendi dhe ligji i zbatueshëm .....	20
2.3. Administrimi i trashëgimisë .....	23
2.4. Pavlefshmëria e testamentit, paditë mbi trashëgiminë .....	24
KAPITULLI III .....	27
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SIPAS LEGJISLACIONIT ITALIAN .....	27



3.1. Instituti i trashëgimisë dhe elementët e tij sipas legjislacionit italian .....	27
3.2. Të drejtat dhe detyrimet dhe radhët e përfitimit të trashëgimisë sipas legjislacionit Italian .....	31
3.3. Shteti si përfitues i trashëgimisë sipas legjislacionit Italian .....	34
KAPITULLI IV .....	36
DALLIMET DHE NGJASHMËRITË E INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË NË SHQIPËRI DHE ITALI .....	36
4.1. Krahasimi i sistemit të dy vendeve mbi institutin e trashëgimisë .....	36
4.3. Dallimet mes dy legjislacioneve mbi të drejtën e trashëgimisë.....	39
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	43
BIBLIOGRAFIA .....	45

## HYRJE

Kërkimi fokusohet në faktin se si funksionon institucioni i trashëgimisë si një institucion themelor në të cilin të drejtat dhe pronat transferohen përmes trashëgimisë ligjore ose testamentare. Zhvillimi i këtij punimi do të jetë një analizë krahasuese me shtetit italian, si një vend nga i cili kemi përfituar mjaft në zhvillimin dhe mbështetjen e kuadrit ligjor rregullator.

Akti i kalimit të pasurisë përmes trashëgimisë është një akt juridik që ndodh pas vdekjes së një personi, pra është akt mortis kauza. Ky kalim pasurie realizohet nëpërmjet çeljes së dëshmisë së trashëgimisë testamentare apo ligjore. Noteri lëshon vendimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, akt publik dhe ligjor që lejon kalimin e titullit tek trashëgimtarët.

Trashëgimia ka karakteristika të trashëguara nga e drejta romake. Ato përfshijnë:

1. Krijimi i marrëdhënies së trashëgimisë: Marrëdhënia e trashëgimisë krijohet me vdekjen e personit të quajtur trashëgimlënës, i cili ka një pasuri të caktuar që do të trashëgojë.
2. Trashëgimia pasurore: Trashëgimia përfshin kalimin e të drejtave pasurore nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët. Kjo përfshin pronat e paluajtshme, pronat e paluajtshme, të drejtat e debive, etj.
3. Marrëdhënie familjare: Trashëgimia zakonisht ka të bëjë me marrëdhëniet familjare, kur trashëgimtari ka lidhje gjaku me trashëgimlënësin. Kjo përfshin trashëgimtë e fëmijëve, prindërve, vëllezërve, motrave, etj.
4. Trashëgimia ligjore: Trashëgimia ligjore përcakton radhën e trashëgimisë dhe rregullat që nuk mund të shkelen. Edhe në rastet e trashëgimisë testamentare, ka kufizime të cilat trashëgimtari nuk mund ti anashkalojë ose ti lërë jashtë

5. trashëgimisë (rezerva ligjore). Kjo siguron një pjesë të trashëgimisë për të afërmit e ndershëm të trashëgimlënësit.

Testamenti është një veprim juridik i caktuar që shpreh vullnetin e trashëgimtarit dhe krijon të drejta dhe detyrime për trashëgimtarët, të cilëve u transferohet pasuria e përcaktuar në testament. Ky veprim krijon një marrëdhënie juridike të vullnetshme. Testamenti mund të anulohet ose modifikohet nga trashëgimtari deri në momentin e vdekjes së tij. Kryerja e testamentit është e rezervuar dhe mund të bëhet vetëm nga testatori ose nga një përfaqësues me prokurë të autorizuar nga ai për të krijuar testament në emër dhe për llogari të tij. Testamenti ka një natyrë të veçantë, pasi krijon pasojat juridike pas vdekjes së testatorit dhe i nënshtrohet parashikimeve ligjore që kufizojnë lirinë e testatorit. Për të qenë i vlefshëm, testamenti duhet të plotësojë formën e përcaktuar nga ligji.

Me vdekjen e një personi trashëgimlënësit të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga trashëgimia i kalojnë personave të quajtur trashëgimtar. Në momentin kur trashëgimlënësi le testament ai shpreh vullnetin e tij dhe ndarjen e pasurisë pa harruar të përfshijë dhe respektojë detyrimet ligjore për mospërjashtimin e kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin. Në mungesë të testamantit, vepron trashëgimia ligjore e cila ka rregullime të detajuara, duke përcaktuar radhën e personave përfitues së kësaj të drejte në disa shkallë, në varësi të lidhjes që ekziston në vijë të drejte ose të tërthortë me trashëgimlënësin.

Në trajtim të përgjithshëm të të drejtës së trashëgimisë, duhet të themi se më poshtë do të trajtohet gjërësisht dhe në imtësi zbatimi dhe rregullimi i kësaj të drejte në dy vendet e përcaktuara për trajtim dhe krahasim, duke nxjerrë në fund edhe të përbashkët apo dallimet që qëndrojnë mes tyre.

Objektivat e temës janë të krahasojnë dhe të analizojnë legjislacionin italian dhe shqiptar në lidhje me institutin e trashëgimisë, duke identifikuar ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Qëllimi i kësaj teme është të ndihmojë në identifikimin e rregullave kryesore të ligjit të trashëgimisë në Itali dhe Shqipëri dhe të vlerësojë efektivitetin e tyre në shpërndarjen e pasurisë dhe të drejtave të trashëgimtarëve. Përmes analizës së ndryshimeve dhe ngjashmërive midis dy legjislacioneve, kjo temë synon të sjellë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit shqiptar në lidhje me institutin e trashëgimisë dhe për të ndihmuar në harmonizimin e tij me legjislacionin ndërkombëtar.

Metodat që do të përdoren në këtë temë janë të analizojnë dhe krahasojnë legjislacionin, përkatësisht Kodet Civile dhe ligjet e lidhura me fushën e institutit të trashëgimisë. Në veçanti, do të përdoren metoda të analizës së tekstit, por edhe studime të fushës për të marrë një vështrim më të gjerë mbi praktikat aktuale dhe sfidat në zbatimin e ligjit të trashëgimisë në këto dy vende.

Në përfundim, kjo temë synon të sjellë një vlerësim të gjerë të legjislacionit italian dhe atij shqiptar në lidhje me institutin e trashëgimisë dhe të japë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit të trashëgimisë në Shqipëri në bazë të praktikave dhe standardeve ndërkombëtare të njohura.

## KAPITULLI I

### KONCEPTET KRYESORE

#### 1.1 Koncepti mbi testamentin

Termi "testament" vjen nga latinishtja "testamentum" dhe në fushën e drejtësisë përdoret për të përshkruar një dokument ose shprehje të vullnetit të një personi, me anë të të cilit ai ose ajo përcakton mënyrën e ndarjes së pasurisë pas vdekjes. Ky veprim ka për qëllim të krijojë një rregullim të veçantë dhe të ndryshëm nga ai ligjor i trashëgimisë, me qëllimin e favorizimit të një rrethi tjetër të trashëgimtarëve, që ndryshon nga ai i përcaktuar nga ligji. Testamenti mund të përfshijë dëshirat e testatorit në lidhje me trashëgimtarët, pronën, detyrimet dhe dispozitat e tjera të veçanta që do të zbatohen pas vdekjes së tij ose saj. (Beyer, 2017) Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm, i dhënë në një formë të caktuar që e imponon ligji dhe që duhet të respektohet pas vdekjes së personit, pasi njihet edhe si vullneti i fundit i trashëgimtarëve për të përcaktuar që kur është gjallë cilët do të jenë trashëgimtarët. (Vorbsi, 2015)

Koncepti i testamentit, është një dokument ligjor që përcakton vullnetin e një individi për shpërndarjen e pasurisë së tij pas vdekjes. (Fleming, 2018) Në legjislacionin shqiptar dhe atë italian, testamenti njihet përkatësisht si "testamenti" dhe "testamento". Si në ligjin shqiptar ashtu edhe në atë italian, testamenti duhet të jetë me shkrim.

Sipas ligjit shqiptar, zotësia për të krijuar testament është rregulluar në nenin 373 të Kodi Civil Shqiptar të vitit 1994. Neni 373 përcakton se çdo person që ka mbushur moshën mbi 18 vjeç ka të drejtën të bëjë testament. Megjithatë, për personin e mitur, i cili ka moshën nga 14 deri në 18 vjeç, ai mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij. Kjo do të thotë që personi i mitur nuk mund të bëjë testament për pasuritë e tjera që

nuk i ka fituar me anë të punës së tij (Neni 373 i Kodi Civil). Në ligj gjithashtu ka disa kufizime të tjera për personat që mund të bëjnë testament. Një person i cili është privuar nga zotësia për të vepruar sipas një vendimi gjyqësor nuk ka të drejtë të bëjë testament. Gjithashtu, në rastin kur personi nuk është në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij në kohën e bërjes së testamentit, sipas ligjit ai nuk mund të bëjë testament (Neni 373/c i Kodi Civil).

Këto kushte janë vendosur për të siguruar se testamenti është i bazuar në vullnetin e vërtetë të personit dhe se ai është në gjendje të kuptojë pasojat e vendimeve të tij testamentare. Testamenti mund të revokohet ose ndryshohet në çdo kohë nga trashëgimlënësi.

Edhe sipas ligjit italian (Kodi Civil Italian, 1942), trashëgimlënësi duhet të ketë gjithashtu zotësi juridike për të bërë një testament të vlefshëm. Testamenti mund të anulohet ose të ndryshohet në çdo kohë nga trashëgimlënësi, por për të qenë i vlefshëm, këto ndryshime duhet të bëhen me shkrim dhe të nënshkruhen në të njëjtën mënyrë si testamenti origjinal. Nëse trashëgimlënësi dëshiron të revokojë ose të ndryshojë testamentin, ai duhet të përdorë një dokument të shkruar që përmban vullnetin e tij të ri, dhe duhet ta nënshkruajë atë në praninë e dëshmitarëve. Është e rëndësishme që trashëgimlënësi të respektojë kërkesat ligjore për testament dhe procedurat e realizimit të testamentit dhe dokumenteve nëse dëshiron që ndryshimet të jenë të vlefshme. Kjo përfshin nënshkrimin e tij dhe dëshmitë e nevojshme për të konfirmuar që trashëgimlënësi ka bërë ndryshimet në mënyrën e duhur. (American Bar Association, 2017)

Në përgjithësi, koncepti i testamentit bazohet në idenë se individët kanë të drejtë të përcaktojnë se si do të shpërndahet pasuria pas vdekjes. Shumë autorë kanë shkruar për rëndësinë e të pasurit një testament dhe për konsideratat e ndryshme ligjore dhe praktike të përfshira në krijimin e një vullneti të vlefshëm dhe efektiv. (Fleming, 2018)

Me të drejtën që i jepet nga ligji, personi mund të vendosë se si do të ndahet pasuria e tij pas vdekjes dhe kush do të trashëgojë çfarë. Nëse trashëgimtarët ligjorë nuk ekzistojnë ose personi dëshiron t'i përjashtojë ata, mund të vendosë se si do të ndahet pasuria e tij me anë të testamentit. (Galgano, 2006)

Ka disa lloje të testamenteve, të cilat ndryshojnë në varësi të vendit ku jeton personi dhe formës së ndjekur. Në Shqipëri dhe Itali, si dhe në shumë vende të tjera, forma më tipike është ajo e testamentit publik. Megjithatë, ka edhe forma të tjera të testamentit që janë të pranishme në legjislacionet e ndryshme.

Trashëgimlënësi me testament (testatori) nuk mund të përjashtojë trashëgimtarët e tij ligjorë nga testamenti, sepse ata kanë një të drejtë ligjore për një pjesë të trashëgimisë. (Muçaj, 2017) Çdo pasuri, e luajtshme apo e palujatshme, ndahen në trashëgimi. (Galgano, 2006)

Trashëgimia është një çështje e rëndësishme për shumicën e njerëzve, dhe një testament i rregullt mund të ndihmojë në mbijetesën dhe mirëqenien e familjes pas vdekjes së një personi. Në vendet e ndryshme ka disa rregulla dhe kufizime në lidhje me testamentin, por në përgjithësi, një testament i rregullt dhe i vlefshëm duhet të plotësojë disa kushte kryesore, siç janë:

- Forma e rregullt: Testamenti duhet të jetë i shkruar në një formë të rregullt dhe të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore për formën e testamentit. Kjo mund të përfshijë nënshkrimin e trashëgimlënësit, dhe dëshmitarëve të pranishëm (në rastin e Italisë), etj.
- Zotësia juridike dhe për të vepruar: Trashëgimlënësi duhet të ketë zotësi juridike dhe të jetë në gjendje për të vepruar në momentin e shkrimit të testamentit. Kjo do të thotë që trashëgimlënësi duhet të jetë në moshën e duhur dhe të ketë aftësinë mendore për të kuptuar dhe shprehur vullnetin e tij në testament (Çela, 2010)
- Testamenti duhet të jetë i nënshkruar nga trashëgimlënësi.
- Mungesa e ndikimeve të jashtme: Testamenti duhet të jetë rezultat i vullnetit të lirë dhe të vetëdijshëm të trashëgimlënësit. Ligjet e vendeve të ndryshme ndalojnë ndikimet, veprimet e detyruara ose të padrejta nga palët e treta që mund të ndikojnë në përcaktimin e testamentit.
- Respektimi i kufizimeve ligjore: Trashëgimlënësi duhet të respektojë kufizimet ligjore që janë të aplikueshme për testamentin në vendin ku ai është bërë. Këto kufizime mund të përfshijnë rregulla specifike për dispozitat testamentare, përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë, të drejtat e trashëgimtarëve të ligjshëm, etj.
- Nenet 373, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410 dhe 411 të Kodit Civil të Vitit 2014 ne Shqipëri rregullojnë rastet kur një testament është i pavlefshëm ose kur mund të ngrihet padia për pavlefshmërinë e tij. Nenet rregullojnë kushtet dhe kufizimet për të krijuar një testament të vlefshëm dhe përmbajnë dispozita të veçanta lidhur me trashëgiminë dhe disponimin e pasurisë përmes testamentit. Neni 373 i Kodit Civil,

për shembull, përcakton se një testament është i pavlefshëm kur është krijuar nga një person që nuk ka autoritetin për të kryer një testament, siç mund të jetë një person i privuar nga aftësia ligjore për të vepruar. Neni 404, në anën tjetër, vendos që një testament të jetë i pavlefshëm nëse nuk plotëson format dhe procedurat e caktuara nga ligji për të qenë i vlefshëm. Këto kushte janë thelbësore për të siguruar sigurinë juridike dhe zbatueshmërinë e testamentit në mënyrë të saktë dhe ligjore.

## 1.2 Koncepti mbi institutin e trashëgimisë

Trashëgimia është një institut i rëndësishëm në sistemin e së drejtës civile dhe paraqet një mënyrë të veçantë për të fituar pasurinë, e lidhur me vdekjen ose mortis causa, në dallim nga metodat e tjera të fitimit të pasurisë që ndodhin gjatë jetës së individëve ose inter vivos. (Barjaba, 2007) Marrëdhëniet e trashëgimisë lindën kur prona u shfaq si një marrëdhënie ekonomike dhe juridike. Marrëdhëniet trashëgimore lindin me vdekjen e një personi të quajtur trashëgimlënës dhe konsiderohen si marrëdhënie pasurore dhe familjare. (Latifi, 2007)

Mendohet se trashëgimia si institucion historik u njoh në të drejtën romake (303 p.e.s). E drejta romake njihete dy institute të trashëgimisë që ishin ajo ligjore dhe testamentare. Prej nga është zhvilluar e deri më sot, është shfaqur në periudha të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. (Latifi, 2007).

Këto dallime rezultuan nga:

- ndryshimet në sistemet politike;
- ndryshimet në legjislacion;
- përafrimi i legjislacionit me të drejtën evropiane;
- ndryshimet historike.

E drejta e trashëgimisë është e ndikuar thellësisht nga sistemet juridike dhe kulturat e ndryshme. Ajo varet nga traditat dhe zakonet e shoqërive të ndryshme, si dhe nga ligjet e



vendosura në to. Në disa shoqëri, trashëgimia ka një rëndësi të veçantë në kalimin e pasurisë përmes linjës familjare, duke i dhënë peshë të veçantë lidhjeve të gjakut dhe historisë familjare. Në këto raste, trashëgimia mund të jetë e lidhur ngushtë me trashëgimtarët ligjorë të caktuar, si fëmijët dhe të afërm të tjerë. Në shoqëri të tjera, theksi mund të vërehet më shumë në pronësinë individuale dhe në të drejtën e individëve për të vendosur për fatin e pasurisë së tyre. Këtu, trashëgimia mund të jetë më fleksibël dhe personi ka më shumë liri për të përcaktuar si do të shpërndajë pasurinë e tij nëpërmjet testamentit. Kështu, trashëgimia është një fushë që reflekton variacionin e rregullave dhe parimeve në lidhje me transferimin e pasurisë nga një brez në tjetrin dhe rrjedh nga ndryshimet kulturore dhe juridike në shoqëritë e ndryshme. (Dari, 2017) Instituti i trashëgimisë pasqyron këto vlera kulturore dhe sociale dhe mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në shpërndarjen e pasurisë brenda një shoqërie. (Knapp, 2017) Në përgjithësi, instituti i trashëgimisë pasqyron ndërveprimin kompleks midis vlerave kulturore, kornizave ligjore dhe të drejtave dhe preferencave individuale. (Torella, 2015)

Trashëgimia është një koncept që në periudha të ndryshme nuk ka ndryshuar. (Dari-Mattiacci, 2017) Institucioni i trashëgimisë është funksion i vazhdimësisë së marrëdhënieve të caktuara juridike ndërmjet personave juridikë edhe pas vdekjes së trashëgimlënësit të “de cuius”, sipas parimit është *de cuius hereditate agitur*. Institucioni i Trashëgimisë garanton stabilitetin dhe vazhdimësinë në qarkullimin civil të të mirave materiale të fituara (d.m.th. të pasurisë) nga individët. (Gjinaj, 2014)

Trashëgimia mund të jetë:

Ligjore- kjo ndodh kur nuk ekziston testamenti. Pasuria është e ndarë sipas formave ligjore, ku ka një renditje për rrethin e trashëgimtareve dhe mënyrën se si ata trashëgojnë. Trashëgimia ligjore aplikohet në rastet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është i pavlefshëm. Kjo do të thotë se në mungesë të vullnetit të shprehur në testament ose në rastin kur testamenti nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë i vlefshëm, ligji përcakton se si do të ndahet pasuria e trashëgimlënësit. Trashëgimia ligjore varet nga parimet dhe rregullat e caktuara në sistemin juridik të një vendi, dhe këto rregulla përcaktojnë radhën dhe pjesën e pasurisë që do të marrin trashëgimtarët ligjorë. (Pop-Georgiev, 1986) Trashëgimia ligjore përcaktohet me ligj, ku shtetet, në varësi të kushteve dhe rrethanave, përcaktojnë në legjisllacionin e brendshëm:

- Personat që trashëgojnë sipas ligjit;
- Mënyra dhe pjesët që trashëgojnë;
- Renditja, e cila përcakton përfituesit duke filluar nga ata që kanë lidhje më të ngushta familjare me të ndjerin.

Trashëgimia ligjore është një mekanizëm i rregulluar ligjërish që siguron që pasuria e personit që vdes të jetë në përputhje me parimet dhe rregullat e caktuara nga shteti. Kjo përfshin caktimin e trashëgimtarëve ligjorë, të cilët kanë të drejtë të marrin një pjesë të pasurisë së trashëgimlënësit në përputhje me hierarkinë dhe rregullat e përcaktuara nga ligji. Trashëgimia ligjore është një mekanizëm i rëndësishëm në sigurimin e drejtësisë dhe mbrojtjes së interesave të trashëgimtarëve në rastet kur nuk ka një testament ose kur testamenti nuk është i vlefshëm. (Pop-Georgiev, 1986)

Testamentare- kjo ndodh kur ekziston një testament. Testamenti është një dokument i shkruar i vullnetit të trashëgimlënësit në lidhje me pasurinë e tij pas vdekjes. Trashëgimtarët e përcaktuar në testament pas çeljes së trashëgimisë marrin pjesën e tyre të trashëgimisë pas pranimi të saj. Trashëgimtarët e perjashtuar, por që janë në lidhje të ngushtë me trashëgimlënësin, mund të kenë të drejtë për një pjesë të trashëgimisë sipas ligjit.

Në përgjithësi, trashëgimia është një proces i rëndësishëm juridik dhe familjar që përcakton se cila pjesë e pasurisë së dikujt do të kalohet tek trashëgimlënësi e tij pas vdekjes. (Sadiku, a2017) Në legjislacionin e shumë vendeve, ka disa kriterë të ndryshme që përdoren për të vendosur se kush mund të jetë trashëgimlënësi dhe sa trashëgimi do të marrin. Këto kriterë mund të përfshijnë lidhjet familjare, statusin martesor, si dhe vullnetin e trashëgimlënësit nëse ka një testament. (Galgano, 2006)

### **1.3 E drejta për të lënë testament**

E drejta për të lënë testament është një koncept ligjor themelor që u lejon individëve të disponojnë pasuritë e tyre pas vdekjes. (Biondi, 2013) Në sistemet ligjore italiane dhe shqiptare, e drejta për të bërë testament është e mbrojtur ligjërish.

Sipas ligjit italian, individët kanë të drejtë të bëjnë testament dhe të disponojnë pasurinë e tyre në përputhje me vullnetin e tyre, por i nënshtrohen disa kufizimeve ligjore. Për të qenë i vlefshëm, testamenti duhet të shkruhet me dorë dhe të nënshkruhet personalisht nga trashëgimlënësi para dy dëshmitarëve të pranishëm, dhe duhet të përmbajë kushte të qarta dhe të përcaktuara. Nëse përmbushen kushtet e duhura, testamenti i lënë nga trashëgimlënësi ka fuqi ligjore dhe pasuria e tij do të shpërndahet në përputhje me dëshirat e shprehura në testament. Kjo përfshin identifikimin e trashëgimtarëve të caktuar dhe përcaktimin e pjesës së tyre në pasurinë e trashëgimlënësit. Këto kufizime dhe procedura ligjore janë vendosur për të garantuar se procesi i testamentit zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe të qartë, duke ndihmuar në parandalimin e abuzimeve dhe kontestimeve të panevojshme. Ligji mbron dhe siguron që vullneti i trashëgimlënësit të respektohet dhe që pasuria të shpërndahet në mënyrë të rregullt në përputhje me dëshirat e tij të shprehura në testament. (Nesi, 2019)

Sipas ligjit shqiptar (Çomo, 2017) testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, ku ai disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Ligji ndalon që testamenti të bëhet nga dy ose më shumë persona në një akt, as për të favorizuar një të tretë, as edhe me disponime reciproke. Në lidhje me zotësinë për të bërë testament, Neni 373 i Kodi Civil përcakton se çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar, ka të drejtë të bëjë testament. I mituri, në grupmoshën 14-18 vjeç, mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij. Persona që janë privuar nga zotësia për të vepruar me vendim gjyqi, si dhe ata që në kohën e bërjes së testamentit nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimit të tyre, nuk kanë të drejtë të bëjnë testament. Nenet 374 dhe 375 rregullojnë zotësinë për të fituar me testament. Neni 374 thekson se janë të pazotë për të fituar me testament ata që nuk mund të trashëgojnë sipas ligjit, përveç fëmijëve të pandërmjetshëm të një personi të caktuar që janë ende të gjallë në kohën e vdekjes së testatorit. Neni 375 kufizon përfitimet e kujdestarit nga disponimet testamentare kur ato janë bërë para miratimit të llogarisë përfundimtare, përveç nëse testatori ka vdekur pas miratimit të llogarisë. Disponimet që janë bërë në favor të kujdestarit janë të vlefshme kur kujdestari është i paralindur, i paslindur, vëlla, motër ose bashkëshorti i testatorit (Neni 375, Kodi Civil). Neni 376 i Kodit Civil të RSH përcakton se disponimi testamentar në favor të personave të pazotë të përmendur në nenet 374 dhe 375 është i pavlefshëm, edhe nëse fshihet nën formën e një kontrate me shpërblim. Persona të ndërvënë përfshijnë babain, nënën, të paslindurit dhe bashkëshortin e personit të pazot

(Neni 376, Kodi civil). Ky rregullim ka si qëllim të kufizojë mundësinë e disponimit të pasurisë në favor të personave të pazotë dhe të sigurojë që trashëgimia ligjore ndjek rregullat dhe kufizimet e vendosura në ligj për të mbrojtur të drejtat e trashëgimtarëve të ligjshëm.

Nënet 377, 378 dhe 379 rregullojnë caktimin e trashëgimtarit dhe përjashtimin nga trashëgimia në ligjin shqiptar.

Neni 377 ofron mundësinë për trashëgimlënësin që nuk ka fëmijë të paslindur ose të paralindur, si dhe vëllezër apo motra, të disponojë pasurinë e tij nëpërmjet testamentit në favor të çdo personi fizik ose juridik të dëshiruar.

Neni 378 lejon trashëgimlënësin të përjashtojë nga trashëgimia ligjore një ose më shumë trashëgimtarë të tij, edhe nëse nuk ka caktuar trashëgimtarë të tjerë në testament.

Neni 379 përcakton se trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim. Trashëgimlënësi gjithashtu nuk mund të cenojë pjesën e tyre ligjore në asnjë mënyrë përmes testamentit, përveç në rastet kur ata janë bërë të pavlefshëm për të trashëguar sipas ligjit.

Këto nene kanë qëllimin të rregullojnë dhe kufizojnë lirinë e trashëgimlënësit për të disponuar pasurinë e tij nëpërmjet testamentit. Ata synojnë të mbrojnë të drejtat e trashëgimtarëve të ligjshëm dhe të sigurojnë që dispozitat testamentare të ndjekin rregullat dhe kufizimet ligjore të vendosura për trashëgiminë (Neni 379, Kodi Civil).

Këto rregulla dhe kufizime ligjore janë të vendosura për të siguruar që procesi i testamentit zhvillohet në përputhje me ligjin dhe që të drejtat dhe dëshirat e testatorit të respektohen. Ata ndihmojnë në rregullimin e trashëgimisë dhe disponimit të pasurisë në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, duke siguruar që vetë dëshira e testatorit të realizohet në përputhje me ligjin.

Studiuesit kanë theksuar rëndësinë e së drejtës për të lënë testament në disa mënyra. (Torella, 2015)

Së pari, e drejta për të lënë një testament ndihmon në promovimin e drejtësisë dhe barazisë në shpërndarjen e pasurisë. Duke i lejuar individët të specifikojnë se kush duhet të marrë pronën e tyre, e drejta për të lënë një testament mund të ndihmojë në parandalimin e

mosmarrëveshjeve dhe konflikteve midis anëtarëve të familjes ose trashëgimtarëve të tjerë të mundshëm.

Gjithashtu, e drejta për të lënë një testament është një element i rëndësishëm i lirisë dhe autonomisë individuale. Duke i lejuar individët të kontrollojnë shpërndarjen e pronës së tyre pas vdekjes së tyre, ndihmon për të siguruar që do të respektohen zgjedhjet e tyre dhe preferencat e tyre, edhe pas vdekjes. (Çomo, 2017)

Kush mund të lërë testament dhe kriteret për të qenë trashëgimtarë varen nga ligjet e vendit ku zbatohet testamenti. Kushtetuta dhe ligjet e vendit ku personi jeton mund të kufizojnë ose të ndryshojnë të drejtat e trashëgimtarëve.

## KAPITULLI II

# RREGULLIMI I INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

### 2.1. Historiku i krijimit të institutit të trashëgimisë në Republikën e Shqipërisë

Shqipëria është një vend ku legjislacioni ka përjetuar ndryshime të shpeshta. Këto ndryshime janë rezultat jo vetëm të zhvillimeve politike, por edhe të fazave tranzitore që shteti i së drejtës ka kaluar. Në historinë e saj, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të ndryshme politike dhe sistemi ligjor nuk ka qenë i përjashtuar nga këto ndryshime. Në disa raste, ndryshimet ligjore kanë ndikuar në rregullimin e institucioneve juridike dhe proceset ligjore të vendit.

Duhet të themi se në priudhat para viteve 1912 kemi një rregullim të dobët mbi këtë institut duke parë edhe vet periudhën që vendi po kalonte, ku nuk kemi as shtet të së drejtës por një shtet i cili nuk ka krijuar autonominë e vet. Edhe në vitet në vijim në Shqipëri, pritej që të vazhdonte të zbatoheshin rregullat që ishin në fuqi edhe para shpalljes së pavarësisë. Kjo për arsye se vendi ende po konsolidohej dhe nuk kishte një legjislacion të plotë dhe norma ligjore të qarta në të gjitha fushat. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, vendi përjetoi një fazë fillestare të rindërtimit institucional dhe krijimit të sistemit ligjor. Në këtë periudhë, u vlerësua se ishte më e arsyeshme të vazhdohej me zbatimin e rregullave dhe normave të vjetra, të cilat ishin të njohura për aktorët juridikë dhe qytetarët. Shteti ishte ende në fazën e tij fillestare të konsolidimit, ndërsa ndikimi i tranzicionit dhe situatave politike dhe shoqërore të vështira gjatë kësaj periudhe ndikuan në mungesën e një

legjislacioni të mirëfilltë rregullues dhe normave ligjore të qarta. Me kalimin e kohës dhe përparimin e shtetit në rrugën e zhvillimit dhe stabilitetit, pritëshin që të ndodhin përmirësime dhe përditësime në sistemin ligjor të vendit. Krijimi i një legjislacioni të plotë dhe normave ligjore të qarta do ta ndihmonte vendin në rregullimin dhe funksionimin e institucioneve ligjore, duke garantuar qasje të barabartë për drejtësi dhe respektim të të drejtave të qytetarëve.

Kështu, e drejta osmane, e cila ekzistonte në Shqipëri para periudhës së pavarësisë, do të vazhdonte të qeveriste të gjitha ndërveprimet ligjore në atë vend, duke përfshirë institucionin e trashëgimisë, i cili drejtohej nga parimet ligjore myslimane që buronin nga Kurani, i njohur si "Sheriati", si burim kryesor i së drejtës që në atë kohë ishte burimi më i lartë i ligjit dhe standardit më të lartë ligjor. Me ardhjen e mbretit Zog në pushtet, klima e tensionuar politike që kishte ekzistuar që nga shpallja e pavarësisë së vendit do të ndryshonte. (Sulçe, 2017)

Me ardhjen në fuqi të mbretit Zog (Libri II. Kodi Civil periudha e Mbretit Zog), shohim një periudhë lulëzimi ku kemi pikërisht hartimin dhe zbatimin e një sërë ndryshimesh rrenjësores në legjislacion dhe pikërisht, hyrja në fuqi e Kodit Civil të Zogut (1929) do të shënonte përkatësinë e së drejtës civile shqiptare në familjen romano-gjermanike. Për më tepër, kjo shënon fundin zyrtar të ligjit osman dhe kalimin e standardeve ligjore në një kornizë demokratike dhe të frymëzuar nga perëndimi. Duhet të pranojmë se kjo periudhë kohore është e njohur në histori edhe për kontributet e saj të shumta në kodifikimin dhe legjislacionin rregullator, ku padyshim patëm reformimin e sistemit dhe ligjeve që ende shihen si shumë efektive tani. Pjesa e dytë e Kodit ka gjithë elementët mbi institutin e trashëgimisë (Neni 7, Libri II), ku sanksionohej se: “Përsa i përket trashëgimisë ligjore apo testamentare, si përsa i përket radhës së trashëgimtarëve, vlefshmërisë thelbësore të akteve testamentare, masës së të drejtave trashëgimore etj, do të zbatohet ligji i shtetit, shtetas i të cilit kishte qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes, pavarësisht nga vendi i ndodhjes së pasurisë apo nëse ishte pasuri e luajtshme apo e paluajtshme”. (Vorbsi, 2015) Pra, nisur nga ky parashikim, mund të themi se e drejta e trashëgimisë lidhej ngushtë me ligjin e shtetësisë së trashëgimlënësit në kohën e vdekjes dhe nuk ndikohej nga vendi i ndodhjes së pasurisë. Sipas parashtrimeve ky është rregullimi ligjor i parë i cili parashikonte në mënyrë kaq specifike zbatimin në hapësirë dhe kohë të ligjit në fushën e institutit të trashëgimisë.

Me rëniën e regjimit të Zogut, si dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore, kemi kalimin ngadalë në një shtet komunist, me një frymë krejtësisht të re nga ku edhe legjislacioni i mëparshëm do të shfuqizohej duke i hapur rrugë krijimit të një legjislacioni krejtësisht të ri bazuar në rregullat dhe metodikën komuniste (Nëpërmjet ligjit nr.61, datë 17.05.1945: “Mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promulguara gjatë okupacionit të huaj dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939”). Lidhur me trashëgiminë, një ndryshim kyç u bë pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Nr. 131 të Gjykatës së Lartë, të njohur si "Drejtësia Popullore", datë 28.96.1948. Kjo ndryshoi situatën e mëparshme dhe çoi në eliminimin e pabarazisë së rolit të gruas në marrëdhëniet trashëgimore. Përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, gruaja kishte një rol të pabarabartë në trashëgimi dhe merrte një pjesë të vogël ose ishte e përjashtuar krejtësisht nga trashëgimia në krahasim me trashëgimtarët e tjerë. Kjo ishte një pabarazi e ndjeshme dhe ndikonte në pozitën e gruas në shoqëri. Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Nr. 131, u bë një hap i rëndësishëm drejt eliminimit të kësaj pabarazie. Gruas iu garantuan të drejta të barabarta në trashëgimi dhe pjesa e saj në pasuri u caktua në përputhje me ligjin, në të njëjtën mënyrë si trashëgimtarët e tjerë. Kjo ndryshoi marrëdhëniet trashëgimore dhe siguroi një trajtim të barabartë për të gjithë individët e përfshirë në trashëgiminë e një personi. Ky ndryshim ligjor pati një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e drejtësisë sociale dhe në adresimin e pabarazive të trashëgimisë. Ai reflektoi një zhvillim të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare dhe përfaqësoi një hap drejt një sistemi ligjor më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët. (Komentar, 2018) Duhet të themi se ishte një evolucion shumë i madh duke marrë në konsideratë rolin e femrës dhe faktin e mosbarazisë dhe diskriminimit të trashëgimisë bazuar në gjinitë.

Nëse referohemi në Kodin Civil të vitit 1982, vërehet se trajtimi i institutit të trashëgimisë në këtë Kod ishte i kufizuar, duke rezultuar në një regres që mund ta cilësohet si një periudhë e errët për vendin, ku shteti largohej gjithnjë e më shumë nga parimet e së drejtës. Megjithatë, pas viteve '90, kemi parë ndryshime të rëndësishme në legjislacion, veçanërisht në vitin 1994, kur u hartua një Kodi Civil i ri, i cili shfuqizoi dispozitat e Kodit të mëparshëm (Kodi Civil 1981) dhe i kushtoi një rregullim në mënyrë të detajuar prej 102 dispozitash institutit të trashëgimisë, ku kemi dhe një hov zhvillimi për këtë institut. Ndër këto dispozita, një vend të vecantë zë edhe ndikimi i elementëve të huaj në institutin e trashëgimisë, fakt i cili pasqyron rëndësinë e së drejtës ndërkombëtare në rregullimin e kësaj marrëdhënie. Ky zhvillim ligjor në vitin 1994 ishte një hap i rëndësishëm drejt



rikthimit në parimet e së drejtës dhe vendosjes së një sistemi ligjor më modern dhe më të drejtë. Këto ndryshime ligjore dëshmuar vullnetin e vendit për të avancuar drejt një shoqërie të bazuar në të drejtën dhe të drejtave të barabarta për të gjithë. Ato reflektojnë angazhimin për përmirësimin e sistemit ligjor dhe krijimit të një ambienti të drejtë për zhvillimin e marrëdhënieve juridike dhe sociale në Shqipëri.

Ndërsa, përsa i përket rregullimit të së drejtës ndërkombëtare private, për këtë periudhë kohore nuk kishte ndryshime. Në këtë periudhë veçoi Ligji Nr. 3920 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj” (Ligji nr. 3920 “Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”). Ky ligj parashikonte disa dispozita mbi trashëgiminë, prsh neni 14 i tij, i cili parashikonte se ligji rregullohet mbi marrëdhënien trashëgimore të të mirave materiale të luajtshme dhe të paluajtshme, do të ishte ligji i shtetit, shtetas (pra concept i lidhur me shtetësinë) i të cilit ishte trashëgimlënësi në çastin e vdekjes. Në paragrafin e dytë, ky nen theksonte se marrëdhëniet që buronin nga trashëgimia e një pasurie të paluajtshme në Republikën Popullore të Shqipërisë rregulloheshin nga ligji shqiptar. Pas kësaj, Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë ka pësuar ndryshime në disa nene specifike, me qëllim të përmirësimit dhe rregullimit të mëtejshëm të institutit të trashëgimisë. Këto ndryshime kanë synuar të përfshijnë çdo problematikë në fushën e trashëgimisë dhe të krijojnë një rregullim më të detajuar dhe të plotë. Duhet të themi se këto ndryshime kanë ardhur dhe si pasojë e nevojës që shoqëria shqiptare ka hasur, si dhe problematikave të shumta të nxjerra nga praktika ndërmjet proceseve gjyqësore (Neni 14).

Pra në mënyrë të përmbledhur themi se historia e krijimit të institutit të trashëgimisë në Shqipëri është e lidhur ngushtë me zhvillimin ligjor dhe politik të vendit. Përpara miratimit të kodit të parë civil modern të vendit në vitin 1929, Shqipëria sundohej nga një sërë sistemesh ligjore dhe zakonesh të ndryshme, shumë prej të cilave u ndikuan nga e kaluara osmane dhe bizantine e vendit. (Çomo, 2017)

Miratimi i kodit civil në vitin 1929 shënoi një kthesë të rëndësishme në zhvillimin e sistemit juridik shqiptar dhe ai përfshinte një sërë rregullash dhe rregulloresh të gjithanshme lidhur me trashëgiminë. (Vukaj, 2014)

Në vitet që pasuan miratimin e kodit civil, Shqipëria pësoi një sërë ndryshimesh politike dhe sociale që patën një ndikim të rëndësishëm në institutin e trashëgimisë. Nën qeverinë komuniste që erdhi në pushtet pas Luftës së Dytë Botërore, sistemi ligjor i vendit u

ndryshua ndjeshëm për të pasqyruar parimet e ideologjisë marksiste-leniniste. Kjo përfshinte ndryshime në ligjet e trashëgimisë, të cilat ishin krijuar për të promovuar pronësinë kolektive të pronës dhe për të zvogëluar ndikimin e të drejtave individuale të pronës.

Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, Shqipëria kaloi një periudhë tranzicioni politik dhe ekonomik dhe ligjet e trashëgimisë iu nënshtruan sërish reformave të rëndësishme. Në vitin 1994, vendi miratoi një kod të ri civil që përfshinte një sërë ndryshimesh në ligjet e trashëgimisë.

Që nga miratimi i kodit të ri civil, Shqipëria ka vazhduar të përmirësojë dhe përditësojë ligjet e saj të trashëgimisë në përgjigje të ndryshimit të kushteve sociale dhe ekonomike. Sot, instituti i trashëgimisë mbetet një pjesë e rëndësishme e sistemit ligjor shqiptar dhe vazhdon të zhvillohet në përgjigje të nevojave të qytetarëve të vendit dhe komunitetit më të gjerë botëror. (Vukaj, 2014)

## **2.2. Rregullimi ligjor i institutit të trashëgimisë sipas legjislacionit shqiptar**

E drejta e trashëgimisë në RSH rregullohet nga legjislacioni i veçantë dhe një sërë standardesh ligjore. Termi "e drejta e trashëgimisë" i referohet tërësisë së normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet pronësore që zhvillohen për shkak dhe pas vdekjes së një personi. Në këtë rast, kalimi i pronës shërben si themeli dhe burimi i të drejtave që pasojnë duke e njohur trashëgiminë si institucion të së drejtës civile: "Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimisë) së personit të vdekur një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod" (Neni 316). Trashëgimia si rregull ka specifikimet e veta mbi vëndin e çeljes së trashëgimisë. Ajo çelet në vendbanimin e fundit të trashëgimlënësit. Kur nuk ka informacion lidhur me vëndin e fundit të trashëgimlënësit atëherë trashëgimia do të çelet në vëndin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa më e madhe e saj (Neni 318/1). Rregullimet specifike mbi këtë marrëdhënie në RSH, parashikohen në Kodin Civil, si norma ligjore bazë e cila zbatohet dhe interpretohet nga gjyqatrët, noterët, avokatët dhe familjarët. Ashtu siç u shpjegua edhe më lart kemi trashëgiminë ligjore dhe testamentare. Tek trashëgimia ligjore kemi një radhë të

caktuar, e cila ndiqet për përcaktimin dhe ndarjen e pasurisë së mbetur nga trashëgimlënësi.

Radha e trashëgimisë ligjore është sipas ndarjes së mëposhtëme (Neni 318):

Sipas përcaktimeve të Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë, në nenin 360 përcaktohet radha e trashëgimtarëve ligjorë “*fëmijët, fëmijët e fëmijve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti*. Këta thirren në trashëgim sipas rradhës të caktuar në këtë Kod”. (Neni 360)

Sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, trashëgimia ndahet në radhë të ndryshme, duke filluar me fëmijët dhe bashkëshortin e trashëgimlënësit. Fëmijët dhe bashkëshorti kanë të drejtë të trashëgojnë secili një pjesë të barabartë të pasurisë. Në rast se një nga fëmijët vdes para trashëgimlënësit ose ka hequr dorë nga trashëgimi, vendin e marrin fëmijët e tij me zëvendësim. Nëse edhe ata fëmijë nuk janë në gjendje të trashëgojnë, atëherë në radhë të parë hyjnë pasardhësit e tyre pa kufizime. Pjesa e prindit që nuk trashëgon ndahet në pjesë të barabarta midis pasardhësve të tij të paslindur.

Nëse nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimia kalon tek bashkëshorti i trashëgimlënësit. Bashkëshorti merr gjithmonë një pjesë të barabartë me 1/2 e trashëgimit.

Sipas nenit 362, fëmijët e lindur jashtë martesës, por të cilët kanë njohur atësinë ose mëmësinë në mënyrë të rregullt, si dhe fëmijët e birësuar, barazohen me fëmijët e lindur nga martesë. Fëmijët e birësuar nuk trashëgojnë në familjen e tyre biologjike dhe as ata nuk trashëgojnë atë (Neni 362).

Në radhë të dytë, në trashëgim thirren prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët kanë jetuar së paku një vit para vdekjes së trashëgimlënësit si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij, sipas nenit 363.

Në radhë të tretë, në trashëgim thirren personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, siç parashikohet në nenin 363, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë. Kështu, thirren gjyshi, gjyshja, vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe

motrave të paravdekur. Trashëgimtarët e radhës së tretë trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa bërë dallim midis vëllezërve dhe motrave të një babai ose vetëm të një nëne, si dhe midis gjyshit dhe gjyshes nga ana e babait ose e nënës (Neni 363).

Në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës të paslindur, prindër, vëllezër, motra, apo të paslindur të tyre, pasuria e trashëgimlënësit kalon tek të afërmit më të afërt, pa dallim midis linjës atërore dhe amësore, por jo më larg se shkalla e gjashtë.

Në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, trashëgimi i takon shtetit. Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e trashëgimlënësit që janë më të larta se vlera e pasurisë së fituar. (Sulçe, 2017)

Përcaktimi i cilësive që duhet të ketë një person për të qenë i aftë për të trashëguar, si dhe përcaktimi i zotësisë për të trashëguar, kanë rëndësi të madhe në lidhje me trashëgiminë.

Sipas ligjit tonë, për të qenë i aftë për të trashëguar, një person duhet të plotësojë dy kushte:

- a) të jetë gjallë në momentin e hapjes së trashëgimisë;
- b) të jetë në radhën e trashëgimtarëve që ligji i ka parashikuar në rastin e trashëgimisë ligjore, ose të jetë trashëgimtar i caktuar në testament në rastin e trashëgimisë testamentare.

Kodi Civil parashikon se një person mund të ketë zotësi për të trashëguar edhe nëse nuk ka qenë gjallë në momentin e hapjes së trashëgimisë, por ka qenë i zënë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja. Përcaktim i afatit të 300 ditëve është bërë duke u bazuar në kritere biologjike dhe mjekësore, pasi një shtatzani mund të zgjasë deri në 300 ditë. Në raste kur personi ka vdekur para trashëgimlënësit ose ka qenë i zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i vdekur, ai nuk ka zotësi për të trashëguar.

Trashëgimtari ka të drejtë të ngrej padi ndaj kujtdo që posedon pasurinë trashëgimore, tërësisht ose pjesërisht, dhe të kërkojë njohjen e tij si trashëgimtar, dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë të fituara me anë të saj. (Vorbsi, 2015)

Me vdekjen e trashëgimlënësit, pasuria trashëgimore kalohet te trashëgimtarët. Në nenin 316 të Kodit Civil, ky term është përdorur për të përshkruar jo vetëm sendet materiale të luajtshme dhe të paluajtshme, por edhe në një kuptim më të gjerë. Termi "pasuri" përfshin të gjitha të drejtat pasurore të personit të vdekur (trashëgimlënësit), të cilat kalohen te

trashëgimtarët e tij. Këtyre personave u kalohen jo vetëm të drejtat e pronësisë mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, por edhe të drejtat e tjera pasurore, si të drejtat e kredisë dhe të drejtat pasurore të autorit (Neni 316).

Neni 322 i Kodit Civil përcakton një numër kategorish të personave që janë të përjashtuar nga trashëgimia si të padenjë. Këta persona janë:

1. Ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij.
2. Ai që ka bërë kallëzim ose ka dhënë dëshmi të rreme ndaj trashëgimlënësit për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose dënim me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë vërtetuar të rreme në një gjykim penal.
3. Ai që me mashtrim, kanosje ose dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të ndryshojë ose të anulohet testamenti, ose ka përpiluar një testament të rreme për të përfituar interesat e tij ose të të tjerëve.
4. Ai që ka trajtuar trashëgimlënësin në mënyrë poshtëruese dhe ka keqtrajtuar atë (Neni 322).

Neni 323 thekson se padenjësia e prindit ose të të paralindurit nuk përjashton fëmijët ose të paslindurit e tyre nga trashëgimia, as kur ata trashëgojnë vetë, as kur vijnë në trashëgim me zëvendësim. Megjithatë, prindi i padenjë në këtë rast nuk mund të ushtrojë të drejtat e uzufuktit dhe të administrimit mbi pasuritë e fëmijëve të tyre (Neni 323).

Neni 324 lejon trashëgimlënësin të falë personin e padenjë për ta trashëguar, nëse falja bëhet në mënyrë shprehimisht me akt notarial ose me testament, ose kur trashëgimlënësi e ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë dhe e ka caktuar atë si trashëgimtar (Neni 324).

Neni 325 përcakton detyrimet e trashëgimtarit të padenjë. Personi i përjashtuar nga trashëgimi si i padenjë detyrohet të kthejë të ardhurat dhe frutat të tjera që ka marrë nga pasuria në trashëgim pas çeljes së trashëgimisë (Neni 325).

Personi i deklaruar si i padenjë nuk ka të drejtë të përfitojë nga pasuria trashëgimore.

Një aspekt i veçanërisht i rëndësishëm është refuzimi i pasurisë trashëgimore (heqja dorë) (Neni 333). Refuzimi i trashëgimisë është një veprim juridik i njëanshëm që përfshin shprehjen e vullnetit të një pale, në këtë rast personit që refuzon trashëgimin. Ky veprim zbatohet pas çeljes së trashëgimisë, pasi vetëm pas fitimit të të drejtave dhe detyrimeve si

trashëgimtar, një person mund ti refuzojë ato. Refuzimi i trashëgimisë nuk mund të kushtëzohet, të ketë një afat kohor ose të kufizohet në një pjesë të trashëgimisë, as në favor të një trashëgimtari. Nëse refuzimi bëhet në këto kushte, ai konsiderohet i pavlefshëm. (Sulçe, 2017)

Heqja dorë nga trashëgimia mund të bëhet përmes shkrimit të një deklarate e cila duhet të regjistrohet në gjykatën e rrethit të vendit ku është çelur trashëgimia, ose me gojë në një procesverbal gjyqësor. Në këtë rast, ky procesverbal duhet të regjistrohet në gjykatën e rrethit të vendit të çeljes.

Përveç këtyre mënyrave, heqja dorë mund të kryhet edhe përmes një përfaqësuesi të autorizuar me prokurë të posacme, i cili përfaqëson dhe realizon veprimet në emër të personit që refuzon trashëgiminë. (Muçaj, 2017)

Zëvendësimi i trashëgimisë zbatohet për fëmijët e fëmijëve dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të pararendësve të vdekur. Trashëgimia me zëvendësim ndahet në zëvendësim drejtpërdrejt dhe zëvendësim tërthortë. (Sulçe, 2017)

Zëvendësimi i drejtpërdrejt ndodh kur një nga fëmijët e trashëgimlënësit ka ndërruar jetë para tij, është shpallur i padenjë, ka hequr dorë nga trashëgimia ose është përjashtuar, dhe në vend të tij hyjnë fëmijët e tij me zëvendësim. Në rast se fëmijët e tij për arsye të përmendura më sipër nuk mund të jenë trashëgimtarë, në trashëgim hyjnë fëmijët e tyre të paslindur, pa asnjë kufizim.

Në rastet kur një trashëgimtar deklarohet i padenjë, nuk është e nevojshme që fëmija i tij të deklarohet si i tillë. Një rast tjetër është kur një trashëgimtar heq dorë nga pjesa e trashëgimisë së tij, shpesh me qëllim që pjesa e trashëgimisë së tij të kalohet tek trashëgimtarët e tjerë. Megjithatë, kjo nuk mund të realizohet nëse ai ka fëmijë nën 18 vjeç, pasi me heqjen dorë, fëmijët e tij thirren në trashëgim.

Në bazë të nenit 378 të K.C., trashëgimlënësit i njihet e drejta që me testament të përjashtojë nga trashëgimia ligjore një ose më shumë trashëgimtarë të tij, por ligji ka vendosur kufizime dhe respekton rezervën ligjore në këtë rast (Neni 378).

### 2.3. Trashëgimia ligjore, të drejtat dhe detyrimet që lindin si pasojë e trashëgimisë

Trashëgimia me ligj aplikohet edhe në situata kur vetëm një pjesë e pasurisë është e lënë me testament ose kur testamenti është i pavlefshëm në mënyrë të pjesshme. Në këto raste, trashëgimia me ligj zbatohet ekskluzivisht për pjesën e pasurisë që nuk është e lënë me testament ose për atë pjesë të testamentit që është e pavlefshme. (Muçaj, 2017)

Trashëgimtarët ligjorë janë personat që iu kalojnë të drejtat trashëgimore sipas rregullave të përcaktuara nga ligji. Trashëgimia ligjore përcakton rrethin e personave që kanë të drejtë të trashëgojnë duke marrë parasysh lidhjen e gjakut, adoptimin dhe marrëdhëniet e caktuara si martesë ose paaftësia për punë. Kodi Civil përcakton se trashëgimtarët ligjorë përfshijnë fëmijët, bashkëshortin pasjetues, prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshin dhe gjyshen, dhe të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë. Për fëmijët, lidhja e gjakut është faktori kryesor, dhe fëmijët e lindur jashtë martesës gëzojnë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga martesë. Ligji vepron po njësoj edhe në rastet e birësimit. (Latifi, 2007)

Gjatë hapjes së trashëgimisë, shpesh ndodh që disa trashëgimtarë të thirren në të njëjtën kohë. Në rastet kur një ose disa trashëgimtarë heqin dorë nga trashëgimia, janë përjashtuar, kanë vdekur para trashëgimlënësit, dhe nuk ka trashëgimtarë që të vazhdojnë trashëgimin me zëvendësim, pjesa e tyre trashëgimore kalon tek trashëgimtarët e tjerë të thirrur në trashëgim (Neni 329). Kjo situatë njihet si "e drejta e shtimit". Për tu realizuar e drejta e shtimit, dy kushte duhet të plotësohen njëkohësisht: (a) trashëgimtari duhet të jetë i vdekur para trashëgimlënësit, të jetë bërë i padenjë për të trashëguar, të jetë përjashtuar nga trashëgimi ose të ketë hequr dorë, dhe (b) të mos ketë trashëgimtarë që ta vazhdojnë trashëgimin me zëvendësim. Nëse trashëgimlënësi ka disponuar të gjithë pasurinë e tij përmes testamentit dhe një nga trashëgimtarët testamentarë ka vdekur para tij, është bërë i padenjë, ka hequr dorë nga trashëgimia ose është përjashtuar nga trashëgimia, dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një trashëgimtar tjetër, për këto raste, pjesa e tij trashëgimore shtohet tek bashkëtrashëgimtarët e tjerë të caktuar në testament sipas pjesëve të tyre trashëgimore (Neni 328/1).

Megjithatë, e drejta e shtimit nuk aplikohet në rastet kur trashëgimlënësi ka disponuar vetëm një pjesë të pasurisë trashëgimore dhe ka caktuar shumë trashëgimtarë testamentarë për këtë pjesë. Në këto raste, pjesa e trashëgimtarit që nuk mund ose nuk dëshiron të

trashëgojë dhe për të cilin trashëgimlënësi nuk ka caktuar zëvendësues, nuk kalon tek bashkëtrashëgimtarët testamentarë, por i kalohet trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit. Shtimi zbatohet vetëm për bashkëtrashëgimtarët e të njëjtës radhë, duke përjashtuar mundësinë që pjesa e pasurisë trashëgimore të kalohet tek radhët e tjera të trashëgimtarëve ligjorë (Neni 383).

#### 2.4. Trashëgimia testamentare, koha, vendi dhe ligji i zbatueshëm

##### *Koha e çeljes së trashëgimisë testamentare.*

Përcaktimi i kohës së çeljes së trashëgimisë është një çështje praktike, shumë e rëndësishme për këtë institut të së drejtës. Koha e çeljes së trashëgimisë sjell dy gjendje të ndryshme juridike:

Së pari, shuarjen fizike të titullarit të të mirave materiale. Në pjesën e përgjithshme në dispozitat që trajtojnë institutin e trashëgimisë, Kodi Civil në nenin 318 të tij ka përcaktuar “*Trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlënësi...*”. Në këtë rast shfaqet dhe një nga karakteristikat e lartpërmendura, pra, fakti se kjo marrëdhënie juridike është marrëdhënie “*mortis causa*” (Neni 318).

*“Duhet të theksojmë gjithashtu se me vdekjen fizike të testatorit do të barazohet edhe vendimi gjyqësor i cili e shpall një person të vdekur”*

*“Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi*

*Neni 15 “Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës...”*

*Neni 17 “Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.”*

*Neni 21 “Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi. Me kërkesën e*



*çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.”*

*Neni 22 “Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë. Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile”,*

Vendimi , përveç faktit të vdekjes, përcakton kështu edhe kohën e ndodhjes së këtij fakti, duke na bërë të pranojmë këtë datë, si ditë të çeljes së trashëgimisë.

Së dyti, thirrjen *ipso iure* të titullarëve të rinj, duke krijuar kështu imazhin e një vazhdimësie, pasi është pikërisht vdekja e testatorit, e cila passjell lindjen e të drejtave dhe detyrimeve të trashëgimtarëve testamentarë mbi pasurinë e disponuar nga vetë testatori. Sipas përcaktimit që bëhet në nenin 20 por edhe në nenin 321 të Kodit Civil, ligjbërësi ynë zbaton parimin e prezumimit *commorentes* (legjislacioni ynë e ka paraparë këtë rregull prej Kodit Civil të vitit 1929, neni 651, e deri në ditët e sotme, përkatësisht në nenin 20 të Kodit Civil: “Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë”, dhe neni 321 “Kur dy ose më shumë persona thirren për të trashëguar njëri tjetrin dhe nuk vërtetohet se cili prej tyre ka vdekur më parë, prezumohet se të gjithë kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe nuk kalon ndonjë e drejtë nga njëri tek tjetri.”), për personat që trashëgojnë njëri-tjetrin dhe vdesin njëkohësisht. Kjo do të thotë se ata nuk trashëgojnë njëri-tjetrin dhe për secilin prej tyre çelet trashëgimia duke thirrur në trashëgim trashëgimtarët e secilit. (Latifi, 2007)

Rëndësia e kohës së çeljes së trashëgimisë ka ndikim në disa dispozita të tjera lidhur me shtrirjen e të drejtave dhe detyrimeve pasurore që i transferohen trashëgimtarëve testamentarë. Vëllimi i këtyre të drejtave dhe detyrimeve përcaktohet vetëm në bazë të atyre të drejtave dhe detyrimeve që testatori kishte në momentin e çeljes së trashëgimisë. Po ashtu, afatet që lidhen me marrëdhëniet e trashëgimisë, siç është afati për heqjen dorë nga trashëgimia ose afate të tjera që fillojnë "nga çelja e trashëgimisë", janë të ndikuar nga koha e çeljes së trashëgimisë. (Muçaj, 2017)

*Vendi i çeljes së trashëgimisë testamentare.*

Një tjetër moment shumë i rëndësishëm është edhe përcaktimi i vendit se ku do të çelet trashëgimia. Në ligj neni 318 përcakton se: *“Trashëgimia çelet....në vendin ku ai ka patur banimin e tij të fundit. Kur ky nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj” (Neni 318).*

Ky nen na jep tri opsione për vendin e çeljes së trashëgimisë, por që realizohen sipas rradhës së vendosur, ose mungesa e të parit referon të dytin e kështu me rradhë. Kjo do të thotë se në rastet kur testatori e ka patur banimin e fundit në një vend të caktuar dhe pasuria trashëgimore ndodhet në një vend tjetër i ndryshëm nga vendi i banimit të testatorit, trashëgimia do të çelet në vendin e banimit të testatorit.

Gjithashtu është për tu patur parasysh fakti se ligji për vendin e çeljes së trashëgimisë testamentare, i referohet vetëm vendbanimit dhe jo vendqëndrimit të testatorit. Pra, thënë ndryshe nuk ka rëndësi për ligjin se ku ka qëndruar testatori në momentin e vdekjes së tij, por e rëndësishme është përcaktimi i vendbanimit të tij në kohën e vdekjes, i cili do të jetë dhe vendi ku do të bëhet çelja e trashëgimisë. (Latifi, 2007)

Përcaktimi i këtij fakti paraqet një tjetër rëndësi praktike, sepse pikërisht nga vendi do të përcaktohet në mënyrë konsekuente gjykata kompetente, e cila do të marrë masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore apo paditë që kanë lidhje me trashëgiminë. Gjithashtu heqja dorë nga trashëgimia, bëhet pikërisht në vendin ku është çelur trashëgimia.

*Edhe Kodi i Procedurës Civile përcakton në nenin 46 të tij se: “Paditë që rrjedhin nga trashëgimi, paditë për pavlefshmërinë e testamentit dhe ato për pjesëtimin e trashëgimit ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e tij të fundit dhe, kur ky nuk dihet, në gjykatën e vendit ku ndodhet e gjithë pasuria ose pjesa më e madhe e saj (Neni 46).*

*Kur trashëgimlënësi është shtetas shqiptar dhe në kohën e vdekjes së tij nuk e ka pasur banimin në Republikën e Shqipërisë, paditë e parashikuara në paragrafin e parë mund të ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e fundit në Republikën e Shqipërisë ose në gjykatën e vendit ku ndodhet pjesa më e madhe e pasurisë së tij.*

*Kur trashëgimlënësi nuk ka pasur në Republikën e Shqipërisë as banim të fundit, as pasuri, paditë si më sipër ngrihen në gjykatën e kryeqytetit.”*

Pra, shohim se dispozitat kanë një lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën sa cenimi i njëres sjell mospërcaktimin e tjetrës.

*Ligji i zbatueshëm për rregullimin e trashëgimisë testamentare.*

Në Kodin Civil, ligji që zbatohet për rregullimin e trashëgimisë përcakton se trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës së vdekjes së trashëgimlënësit (Neni 313/1). Kjo do të thotë se, pavarësisht nga konflikti midis trashëgimtarëve për çështjet e trashëgimisë, ligji që do të zgjidhë këto konflikte është ligji i kohës së vdekjes së testatorit. Ky përcaktim është konfirmuar edhe me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 24 datë 13.03.2002, ku Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate unifikojnë praktikën si më poshtë: *"Trashëgimia çel në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, i cili është konstatuar fizikisht ose përcaktuar me vendim gjyqësor të shpalljes së vdekjes. Përcaktimi i këtij momenti ka një rëndësi praktike të veçantë, pasi nëpërmjet tij përcaktohet grupi i trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi, të drejtat e tyre dhe momenti i transferimit të të drejtës së trashëgimisë..."*.

Si rregull parimi i ligjit të kohës së çeljes së trashëgimisë vepron edhe për trashëgiminë testamentare, ndonëse për këtë të fundit jo për çdo rast. Kjo ka të bëjë me faktin se, ndryshe nga trashëgimia ligjore, që me vërtetimin e vdekjes së personit fizik, rregulli i kalimit vepron *ipso iure*, e drejta testamentare gjen zbatim vetëm nëse paraqitet akti juridik i përpiluar nga testatori konform ligjit, i cili siç dihet, paraqet diferenca ndërmjet kohës së përpilimit dhe kohës së çeljes së testamentit (periudhë kjo e cila mund të jetë edhe shumë e zgjatur në kohë). (Gjinaj, 2014)

### **2.3. Administrimi i trashëgimisë**

Në kontekstin e pasurisë trashëgimore, ka raste kur është e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, kreditorëve dhe shtetit. Në këtë drejtim, gjykata e vendit ku trashëgimia është çelur vepron nëpërmjet kërkesës së trashëgimtarëve ose personave të interesuar, ose nëpërmjet iniciativës së saj për të emëruar një përmbarues gjyqësor që të bëjë inventarin e pasurisë trashëgimore. Në situatat kur nuk dihet nëse ka trashëgimtarë, ata mungojnë dhe nuk ka lajme për ta, ose kanë refuzuar trashëgiminë dhe trashëgimtarët e tyre nuk janë të njohur, gjykata e rrethit ku trashëgimia është çelur, me kërkesën e personave të interesuar që mund të jenë trashëgimtarë, kreditorë të trashëgimtarit ose vetë shteti, zakonisht emëron

një kujdestar. (Mystafai, 2002) Pra gjykata ka rolin e rëndësishëm për të mbrojtur interesat e të gjithë palëve të interesuara.

Detyra e kujdestarit është të administrojë pasurinë trashëgimore dhe ai nuk mund të kryejë veprime që tejkalojnë kufijtë e këtij administrimi. Në disa raste të caktuara dhe me miratimin e gjykatës së vendit ku trashëgimia është çelur, detyra e kujdestarit mund të tejkalojë kufijtë e administrimit të thjeshtë dhe të përfshijë disponimin e pasurisë. Sipas Nenit 345 të Kodi Civil, "Kujdestari kërkon të bëjë inventarin e pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe i përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgimi ose që rrjedhin prej saj, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit." (Neni 345) Kujdestari jep llogari në lidhje me administrimin e pasurisë trashëgimore para gjykatës që e ka emëruar. Gjykata, në lidhje me administrimin e pasurisë trashëgimore, mund të ngarkojë kujdestarin përveç veprimeve të zakonshme të administrimit dhe veprimeve të disponimit. Sipas ligjeve të shumë vendeve të botës, kujdestari ka të drejtë të disponojë të gjitha llojet e pasurisë trashëgimore, të paluajtshme dhe të luajtshme. Ligji ynë nuk e rregullon këtë çështje drejtpërdrejt, por thjesht nga interpretimi i faktit se kujdestari luan rolin e përfaqësuesit ligjor të përkohshëm në lidhje me pasurinë trashëgimore, arrin në këtë konkluzion. Ligji ynë pranon faktin që veprimet e kujdestarit mund të tejkalojnë kufijtë e administrimit të zakonshëm të pasurisë trashëgimore dhe ato do të jenë veprime disponimi. (Mystafai, 2002)

#### **2.4. Pavlefshmëria e testamentit, paditë mbi trashëgiminë**

Testamenti, si shprehje e vullnetit të ligjshëm të një personi për të përcaktuar fatin e pasurisë së tij pas vdekjes, mund të përballet me dispozita të ligjit që kufizojnë dhe përcaktojnë kushtet e tij të vlefshmërisë. Në Kodin Civil, ekzistojnë rregulla të hollësishme (nenet 403-410) që përcaktojnë rastet kur një testament mund të shpallet i pavlefshëm. Këto rregulla specifikojnë kriteret sipas të cilave një testament mund të jetë i pavlefshëm dhe kufizojnë pavlefshmërinë e testamentit vetëm nëse ato nene janë shkelur (Nenet 403-410). Kjo qasje është ndjekur për të theksuar rëndësinë dhe pasojat e pavlefshmërisë së testamentit, si dhe për të shmangur interpretimet arbitrare të gjykatave lidhur me

vlerësimin e vlefshmërisë së testamentit. Megjithatë, ligji nuk ka specifikuar hollësisht çfarë shkaqesh shkaktojnë pavlefshmërinë absolute dhe cilat shkaktojnë pavlefshmërinë relative të testamentit.

Shkaqet e pavlefshmërisë së testamentit duhet të shikohen në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe jo në kohën e redaktimit të tij. (Nuni, 2010)

### *I. Pavlefshmëria absolute.*

Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë pavlefshmërinë e testamentit në rastet e pavlefshmërisë absolute janë çdo person i interesuar, madje dhe gjykata, ka të drejtë dhe detyrë që edhe kryesisht (pa kërkesë të palës), të konstatojë pavlefshmërinë absolute.

Në rastin e pavlefshmërisë absolute vendimi gjyqësor që konstaton pavlefshmërinë e testamentit është me karakter njohës ose deklarativ dhe gjykata mjaftohet vetëm me konstatimin e kësaj pavlefshmërie, duke rregulluar dhe pasojat e kësaj pavlefshmërie të testamentit.

Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë për pavlefshmërinë absolute të testamentit, mund të themi se kjo padi mund të ngrihet në çdo kohë, mjafton që në çastin e ngritjes së kësaj padie të ekzistojë shkak i pavlefshmërisë.

### *II. Pavlefshmëria relative.*

Në rastin e pavlefshmërisë relative vendimi gjyqësor është me karakter krijues ose konstitutiv dhe gjykata kur e shpall këtë lloj pavlefshmërie deklaron shkaqet pse testamenti është i pavlefshëm, duke rregulluar kështu dhe pasojat që sjell kjo pavlefshmëri.

Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë pavlefshmërinë e testamentit në rastet e pavlefshmërisë relative, janë vetëm personat e interesuar dhe jo çdo person, madje dhe vetë gjykata kryesisht nuk mund të kërkojë pavlefshmërinë relative. (Nuni, 2010)

Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë për pavlefshmërinë relative të testamentit, mund të themi se kjo padi mund të ngrihet brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji, domethënë, brenda tri viteve nga çelja e trashëgimisë. (Hakani, 2010) Por këtu vihet re një ndryshim për sa i takon testamentit si veprim juridik, pasi të gjitha veprimet juridike, afatin e parashkrimit të tyre për kërkesa të ndryshme e kanë pesë vite, ndërkohë që për këtë veprim juridik ky përcaktohet nga ligji si një afat tre vjeçar. Ligji dhe as literatura juridike nuk e bëjnë këtë arsyetim.

Rastet e pavlefshmërisë relative janë:

- a) Kur testamenti është bërë nga testatori nën ndikimin e mashtrimit, gjë e cila nënkupton përdorimin e gënjeshtëris ndaj testatorit, në mënyrë që ta çojë atë në gabim për të hartuar testamentin. Mashtrim ky i cili duhet të ekzistojnë në momentin që testatori harton testamentin, pra që ndikon drejtpërdrejtë në vullnetin e testatorit. Mashtrimi duhet të jetë i rëndësishëm dhe thelbësor, aq sa pa ekzistencën e tij testatori nuk do ta bënte testamentin. (Nuni, 2010)
- b) Kur testamenti është bërë nga testatori në kushtet e kanosjes, e cila nënkupton dhunën psikike që i bëhet testatorit. Kjo kanosje duhet patjetër që të jetë serioze, reale, e drejtëpërdrejtë e kryer nga personi kërcënues, pra të jetë sjellje e padrejtë e këtij të fundit. Vetëm nëse këto kushte do të bashkëekzistojnë atëherë do të jemi përpara kësaj pavlefshmërie relative.
- c) Kur testamenti është hartuar nga testatori nën ndikimin e lajthimit, i cili konsiston në përfytyrimin e gabuar të fakteve dhe rrethanave nga ana e testatorit. Lajthimi duhet të ketë ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e testatorit, të ketë të bëjë me vetë testatorin, si dhe ajo që është më e rëndësishmja të ketë të bëjë me cenimin e një nga elementëve të domosdoshëm të testamentit, si psh, caktimi i rrethit të trashëgimtarëve apo pjesa takuese e tyre etj...
- d) Kur testamenti është hartuar nga testatori kur ai ka qenë në gjendje të tillë që nuk ka kuptuar rëndësinë e veprimit që po kryen. Rast ky i parashikuar në nenin 94/c i Kodit Civil, psh. kur testatori në momentin e hartimit të testamentit, ka qenë në gjendje të dehur të rëndë (Neni 94/c, Kodi civil)

## KAPITULLI III

### INSTITUTI I TRASHËGIMISË SIPAS LEGJISLACIONIT ITALIAN

#### 3.1. Instituti i trashëgimisë dhe elementët e tij sipas legjislacionit italian

Kodi Civil Italian është i përbërë nga gjashtë libra, dhe njëri prej tyre trajton trashëgiminë, në Librin II, me titullin "Trashëgimia". Pas dispozitave të përgjithshme të Titullit I, vazhdon me trashëgiminë ligjore (Titulli II) dhe më pas me trashëgiminë testamentare (Titulli III). Në sistemin juridik italian, ekziston një procedurë e deklarimit të trashëgimisë për trashëgimtarët, e cila kërkohet të paraqitet në Zyren e Taksave brenda 12 muajve pas vdekjes së trashëgimtarit, veçanërisht në rastet kur ai ka lënë pasuri të paluajtshme. Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së personit, pikërisht në vendbanimin e tij të fundit (Neni 456, Kodi Civil Italian). Sipas nenit 457/1, "trashëgimia kalon ose nëpërmjet ligjit ose testamentit" (Neni 457/1, Kodi Civil Italian).

Në rastin e parë, trashëgimia kalon nëpërmjet ligjit, ku të afërmit e trashëgimtarit trashëgojnë si trashëgimtarë të ligjshëm (Neni 457/2, Kodi Civil Italian).

Nëse i ndjeri ka vdekur pa testament nëpërmjet të cilit të ketë disponuar pasurinë e tij, ligji italian përcakton se cilët të afërm kanë të drejta legjitime të trashëgimisë dhe kuotën përkatëse të pasurive. Në mungesë të ndonjë personi që ka të drejtë të trashëgojë deri në shkallën e 6-të të farefisnisë, pasuria i kalohet shtetit.

Lidhja farefisnore mund të jetë e dy llojeve të ndryshme:

- farefisnia e drejtpërdrejtë (babai – fëmijët; gjyshi – nipërit): në këtë rast, anëtarët e familjes rrjedhin drejtpërdrejt nga njëri-tjetri;

- lidhje farefisnore kolaterale (vëllezërit dhe motrat; daja – nipi):

në këtë rast, pavarësisht se kanë një pasardhës të përbashkët, anëtarët e familjes nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga njëri-tjetri.

Anëtarët e familjes që kanë të drejtë të konsiderohen si trashëgimtarë të ligjshëm sipas ligjit italian të trashëgimisë janë:

- Bashkëshorti ose partneri civil.

- Fëmijët, ku fëmijët e ligjshëm kanë të njëjtat të drejta si fëmijët natyrorë, të birësuar dhe të legjitimuar.

- Pasardhësit e ligjshëm (babai, nëna, gjyshi, gjyshja),

- Të afërmit / anëtarët e tjerë të familjes deri në shkallën e gjashtë të farefisnisë.

- Shteti Italian (kur nuk ka trashëgimtarë ose disponime të tjera).

Afërsia e farefisnisë përcakton trashëgiminë dhe do të përjashtojë lidhjet farefisnore më të largëta. Kjo njihet si, "Diritto di Precedenza" (Përparësi nga afërsia).

Nëse trashëgimtarët janë anëtarë të familjes me të njëjtën shkallë farefisnore, secili do të marrë një pjesë të barabartë të pasurisë së të ndjerit.

Rezerva ligjore, në kontekstin e trashëgimisë, paraqitet në dy raste të veçanta:

1. Kur trashëgimtari ka bërë testament, por nuk ka përfshirë të afërm të caktuar, të cilëve ligji ua njeh të drejtën e trashëgimisë, duke caktuar një kuotë të caktuar të pasurisë trashëgimore për ta.
2. Kur trashëgimtari vdes pa bërë testament, por gjatë jetës së tij ka dhuruar të mira materiale në një masë të tillë që çënon të drejtën e trashëgimisë së të afërmeve.

Në rastin e dytë, ky kufizim i trashëgimisë aplikohet për të mbrojtur interesat e të afërmeve të ngushtë në bazë të vullnetit të trashëgimlënësit. Sistemi juridik italian i trashëgimisë ka rrënjë në traditën e së drejtës romake, e cila vlerëson dhe mbron interesat e anëtarëve të ngushtë të familjes së të ndjerit. Kjo rezervë ligjore kufizon pjesërisht të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar plotësisht pasurinë sipas dëshirës së tij.



Në rastin e trashëgimisë testamentare, ligji parashikon mënyrën e transferimit të pasurisë trashëgimore tek trashëgimtarët përmes testamentit. (Guida, 2022) Testamenti, siç e përcakton ligji, është një akt i revokueshëm me anë të të cilit trashëgimtari disponon pasurinë e tij ose një pjesë të saj pas vdekjes.

Siç u përmend më parë, një nga parimet e trashëgimisë në Itali është mbrojtja e familjes. Si rezultat i kësaj, disa trashëgimtarë nuk mund të përjashtohen nga trashëgimia. Edhe në rast të trashëgimisë testamentare, një pjesë, ose, “kuota” e pasurisë së të ndjerit (kuota e rezervuar) duhet t'u caktohet trashëgimtarëve që mbrohen nga rezerva ligjore. Kodi Civil Italian përcakton saktësisht kuotën e trashëgimisë në dispozicion të trashëgimlënësit. Domethënë, kuotën që trashëgimlënësi mund ta disponojë lirisht pa asnjë kufizim ligjor.

Ligji italian rezervon një kuotë të trashëgimisë për trashëgimtarët të cilët janë:

- a) Fëmijë të ligjshëm, natyralë, të birësuar
- b) të martuar/partner të regjistruar
- c) pasardhësit legjitimë (të vlefshëm në mungesë të fëmijëve).

Trashëgimlënësi përjashton nga trashëgimia personin që:

1. ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimtarin, bashkëshortin, një pasardhës, ose një paraardhës të tij (Kodi Civil, neni 801);
2. ka kryer një veprim apo dëm kundrejt këtyre personave për të cilin kodi penal parashikon të aplikueshme dispozitat për vrasje (Kodi Penal, nenet 397, 579, 580);
3. Në rastet kur një person ka paraqitur kallëzim ose ka dhënë dëshmi të rreme në lidhje me një person të caktuar për një veprim penalisht të ndaluar që parashikon dënime burgimi të përjetshëm ose burgimi të pakufizuar me një periudhë jo më shumë se tre vjet, dhe ky kallëzim ose dëshmi është vlerësuar si i rrem në një proces gjyqësor penal (Kodi Penal, Neni 368).
4. ka mashtruar ose ka ushtruar dhunë ndaj trashëgimtarit për ta bërë, revokuar ose ndryshuar testamentin ose e ka penguar në bërjen e tij duke shfrytëzuar mashtrimin ose dhunën (Kodi Civil, neni 1439);
5. Në rastet kur një person ka fshehur ose ka ndryshuar testamentin me të cilin është rregulluar trashëgimia.

6. Ka bërë një testament të rremë ose e ka përdorur atë.

Personi i shpallur si i padenjë është i obliguar të kthejë të ardhurat dhe përfitimet që ka marrë pas hapjes së trashëgimisë. Në rastin e një personi të padenjë, prindi nuk mund të përfitojë nga të drejtat e përdorimit dhe administrimit të pasurisë së fëmijës së tyre, siç i njeh ligji prindërve.

*Pranimi ose heqja dorë nga një trashëgimia*

Çdo trashëgimtar është gjithmonë në gjendje të heqë dorë nga të drejtat për të trashëguar, por do të fitojë kualifikimin e trashëgimtarit sapo të pranojë trashëgiminë. Pasi pranohet, kualifikimi i trashëgimtarit është i parevokueshëm. Pranimi mund të jetë i shprehur ose i heshtur. Në secilin rast, pranimi duhet të manifestohet brenda 10 viteve nga hapja e procesit të trashëgimisë. Pranimi i shprehur i trashëgimisë bëhet kur trashëgimtari deklaron gatishmërinë për të pranuar statusin e trashëgimtarit, me anë të një akti noterial ose privat. Pranimi i heshtur ndodh kur dikush vepron në atë mënyrë që pranimi për të trashëguar mund të nënkuptohet. Pranimi mund të bëhet edhe në bazë të “beneficium inventarii”. Në këtë mënyrë, pasardhësi rezervon të drejtën të pranojë ose të heqë dorë nga një trashëgimi duke marrë parasysh nëse borxhet mbi pasurinë e kalojnë ose jo vlerën e pasurisë. (Galgano, 2020) Në këtë mënyrë, trashëgimtari është në gjendje të shkarkojë veten nga shlyerja e borxheve duke hequr dorë nga trashëgimia. Në përgjithësi, pasardhësit vendosin të heqin dorë nga trashëgimia në rastet kur borxhet e të ndjerit tejkalojnë vlerën e pasurisë që do të trashëgohet. Trashëgimtarët duhet të paguajnë borxhet e të ndjerit deri në vlerën e pasurisë që trashëgojnë. Kur një trashëgimtar heq dorë nga një trashëgimi, trashëgimtari duhet të njoftojë publikisht refuzimin përpara një noteri publik ose një zyrtari publik, pasi akti i heqjes dorë nga trashëgimi nuk mund të bëhet në një dokument privat. Në rastin e trashëgimisë ligjore, pjesa e atij që heq dorë nga trashëgimia i shtohet trashëgimtarëve të tjerë në të njëjtën radhë me personin që heq dorë. (Guida, 2022)

Procedura italiane e trashëgimisë nënkupton procedura mjaft komplekse burokratike dhe kërkon që një sasi e konsiderueshme informacioni dhe dokumentesh t'u dorëzohet autoriteteve kompetente italiane. Në rast të trashëgimisë në lidhje me shtetasit jo-italianë, çështja është edhe më e ndërlikuar për shkak të rregulloreve të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare dhe konfliktit të mundshëm ndërmjet legjislacionit. Në veçanti, legjislacioni italian i trashëgimisë ndryshon thelbësisht nga ligjet në fuqi në juridiksionet e Common Law.

### **3.2. Të drejtat dhe detyrimet dhe radhët e përfitimit të trashëgimisë sipas legjislacionit Italian**

Sipas legjislacionit italian, të drejtat dhe detyrimet e trashëgimisë rregullohen nga Kodi Civil i Italisë. Kur një person vdes, pasuria e tij u shpërndahet trashëgimtarëve të tyre në përputhje me ligjin ose me dëshirën e tyre nëse ata kanë bërë një testament të vlefshëm. Edhe në legjislacionin e shtetit Italian kemi të përcaktuar në mënyrë të shprehur radhën e thirrjes në trashëgim.

Radha e thirrjes në trashëgim është e rregulluar si vijon:

- a) Nëse trashëgimtari ka fëmijë të ligjshëm natyralë ose të adoptuar, pasuria trashëgimore u ndahet atyre në pjesë të barabarta. Bashkëshortit, nëse është i gjallë, i takojnë gjysma ose 1/3 e pasurisë sipas rrethanave, nëse ai konkurren me një fëmijë ose më shumë fëmijë.
- b) Nëse trashëgimtari nuk ka fëmijë, 2/3 e pasurisë i takojnë bashkëshortit dhe 1/3 i kalon prindërve, vëllezërve dhe motrave (në rast se prindërit, vëllezërit dhe motrat mungojnë, e gjithë pasuria i kalon bashkëshortit).
- c) Nëse trashëgimtari nuk ka fëmijë dhe as bashkëshort të gjallë, trashëgojnë prindërit, vëllezërit e ligjshëm dhe motrat e ligjshme (në rast se prindërit mungojnë, e gjithë pasuria i kalon vëllezërve dhe motrave; nëse vëllezërit dhe motrat mungojnë, pasuria i kalon prindërve).
- d) Nëse asnjëri prej këtyre nuk është i gjallë, pasuria trashëgimore i kalon të afërmeve farefisnorë, pa dallim linje, filluar nga shkalla më e afërt deri në shkallën e gjashtë. Kur nuk ka të afërm brenda shkallës së gjashtë, pasuria trashëgimore i kalon shtetit.

Ndarja e kuotës së trashëgimisë realizohet në përputhje me nenet 565-586 të Kodit Civil Italian, të miratuar me R.D. 16 mars 1942, nr. 262.

Ndarja e kuotës (nenet 565-586) së trashëgimisë bëhet si më poshtë (Kodi Civil Italian, R.D. 16 mars 1942, nr. 262 Miratimi i tekstit të Kodit Civil):

1. Trashëgimia midis fëmijëve (pasardhësve), por jo bashkëshortit: Në këtë situatë, trashëgimia ndahet në pjesë të barabarta midis fëmijëve. Nëse një fëmijë është i

- paravdekur dhe ka fëmijë të vetë, ata trashëgojnë pjesën që do të kishte takuar prindi i tyre, duke e ndarë ndërmjet tyre në pjesë të barabarta, duke u bazuar në të drejtën e përfaqësimit (Nenet 467-469).
2. Trashëgimia midis bashkëshortit dhe pasardhësve: Bashkëshortit i takon gjysma e trashëgimisë nëse konkuron me një fëmijë, ndërsa 1/3 nëse ka dy ose më shumë fëmijë. Ndarja midis fëmijëve bëhet siç u përmend më sipër, duke u zbatuar gjithmonë të drejta e përfaqësimit për fëmijët, por jo për bashkëshortin.
  3. Trashëgimia vetëm për bashkëshortin, por jo për paraardhësit ose të afërm të tjerë: Në këtë rast, bashkëshortit i takon tërë trashëgimia.
  4. Trashëgimia vetëm për bashkëshortin, paraardhësit ose të afërm të tjerë, por jo për pasardhësit: Në këtë rast, bashkëshortit i takojnë 2/3 e trashëgimisë, ndërsa 1/3 i takon paraardhësve ose të afërmeve të tjerë.
  5. Trashëgimia vetëm për paraardhësit ose të afërm të tjerë, por jo për bashkëshortin dhe pasardhësit: Në këtë rast, trashëgimia ndahet ndër paraardhësit ose të afërm të tjerë. Ndarja bëhet në mënyra të ndryshme, por në përgjithësi vëllezërit, motrat dhe prindërit e gjallë trashëgojnë në pjesë të barabarta. Pjesa minimale për prindërit është gjysma e trashëgimisë.
  6. Trashëgimia për të afërm të tjerë deri në shkallën e gjashtë: Në këtë rast, trashëgimtarët e radhës së dytë përjashtojnë ata të radhës së parë. Ndarja bëhet sipas brezave dhe në përgjithësi ndahet në pjesë të barabarta. (Galgano, 2006)

*Perfitimi i trashëgimisë sipas legjislacionit italian sjell disa të drejta për trashëgimtarët si:*

Të drejta për trashëgimtarët:

- a. Të drejta për të marrë pronën: Trashëgimtari ka të drejtë për të marrë pronat dhe pasuritë që janë trashëguar nga personi i cili ka vdekur.

b. Të drejta për të vendosur për pronën: Trashëgimtari ka të drejtë për të vendosur për trashëgiminë dhe për të ndarë pronën në përputhje me dispozitat e ligjit dhe vullnetin e personit që ka vdekur.

c. Të drejta për të mbajtur pronën: Trashëgimtari ka të drejtë për të mbajtur pronën e trashëguar dhe për të përfituar nga ajo, duke e përdorur atë në përputhje me rregullat dhe kufizimet e ligjit.

Të drejta për të përfituar nga përfitimet financiare:

a. Të drejta për të marrë të ardhurat nga pronat: Trashëgimtari ka të drejtë për të marrë të ardhurat e prodhuara nga pronat e trashëguara, përfshirë qiratën ose të ardhurat nga shitja e pronës.

b. Të drejta për të kërkuar pagesa të papaguara: Trashëgimtari ka të drejtë për të kërkuar pagesa të papaguara ose të përfitojë nga çdo e drejtë financiare që i takon trashëgimtarit në lidhje me pronën e trashëguar.

Të drejta për të kërkuar drejtësi dhe mbrojtje ligjore: (Nesi, 2019)

a. Të drejta për të mbrojtur trashëgiminë: Trashëgimtari ka të drejtë për të mbrojtur trashëgimin nga pretendimet e paligjshme të të tjerëve dhe për të luftuar ndonjë veprim të padrejtë që kërcënon pronën e trashëguar.

b. Të drejta për të kërkuar ndihmë ligjore: Trashëgimtari ka të drejtë për të kërkuar ndihmë dhe këshillim nga avokatët dhe juristët për çështje të lidhura me trashëgiminë dhe për të përmbushur detyrimet ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se këto të drejta janë specifike për trashëgimtarët dhe variojnë në varësi të rregullave të ligjit dhe rrethanave të veçanta të secilës trashëgimi. Gjithashtu, rregullat dhe procedurat e trashëgimisë mund të ndryshojnë në varësi të statusit ligjor të trashëgimtarit (p.sh., trashëgimtari i zakonshëm, trashëgimtari me testament, etj.) dhe vendosjes së testamentit të personit që ka vdekur.

*Perfitimi i trashëgimisë sipas legjislacionit italian vjen me disa detyrime për trashëgimtarët. Këtu janë disa prej tyre:*

Detyrimi për të pranuar trashëgimin: Trashëgimtari ka detyrimin ligjor të pranojë trashëgimin e tij në një kohë të caktuar nga ligji. Refuzimi i trashëgimisë duhet të bëhet në mënyrën dhe afatet e caktuara nga ligji.

Detyrimi për të shlyer detyrimet e personit të vdekur: Trashëgimtari ka detyrimin për të shlyer detyrimet financiare të personit që ka vdekur, përfshirë borxhet, taksat dhe kreditorët e tij. Trashëgimtari është përgjegjës për shlyerjen e këtyre detyrimeve me pasurinë e trashëguar.

Detyrimi për të ndarë trashëgiminë: Nëse ka më shumë se një trashëgimtar, ata kanë detyrimin për të ndarë pronën e trashëguar. Nëse nuk ka një marrëveshje ndarëse të arritur midis trashëgimtarëve, gjyqi mund të vendosë për ndarjen e trashëgimisë sipas dispozitave të ligjit.

Detyrimi për të informuar autoritetet: Trashëgimtari ka detyrimin për të njoftuar autoritetet kompetente për trashëgiminë dhe për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të konfirmuar statusin e tij si trashëgimtar.

Detyrimi për të respektuar vullnetin e testatorit: Nëse ekziston një testament i vlefshëm, trashëgimtari ka detyrimin për të respektuar dëshirat e testatorit dhe të zbatojë dispozitat e testamentit. (Torella, 2015)

Detyrimi për të paguar taksat trashëgimore: Trashëgimtari ka detyrimin për të paguar taksat trashëgimore dhe detyrimet financiare të tjera që vijnë si rezultat i perfitimit të trashëgimisë.

Detyrimi për të përmbushur rregullat ligjore: Trashëgimtari ka detyrimin për të përmbushur rregullat ligjore dhe procedurat e trashëgimisë, duke iu nënshtruar dispozitave të ligjit dhe kushteve të vendosura nga autoritetet kompetente.

Këto janë disa nga detyrimet kryesore që rrjedhin nga perfitimi i trashëgimisë sipas legjislacionit italian.

### **3.3. Shteti si përfitues i trashëgimisë sipas legjislacionit Italian**

Edhe në legjislacionin Italian shteti është përfitues i radhës së fundit të trashëgimtarëve ligjor, kur këta të fundit nuk ekzistojnë ose për shkaqe ligjore nuk janë përfitues. Ka një sërë debatesh dhe nga doktrina dhe nga akademikët nëse shteti duhet të përfshihet si përfitues i kësaj pasurie, e cila konsiderohet pasuri vetjake. Një parakusht për vazhdimësinë e përfitimit si trashëgimtar i shtetit është një "trashëgimi e zbrazët", një fenomen që ndodh

kur nuk ekziston asnjë person legjitim i radhës ligjore si dhe nuk kemi një testament të ligjshëm; trashëgimi mund të ekzistojë edhe nëse pasardhësit ekzistojnë, por kanë humbur të drejtën e pranimi me heqje dorë, paligjshmëri ose konfiskim. (Gottardi, 2017) Arsyetimi i këtij lloji të trashëgimisë duhet të identifikohet jo vetëm në nevojën për të kompensuar mungesën e ndonjë pasardhësi, por edhe në dëm të ligjvënësis drejt një trashëgimie testamentare që nuk bazohet në punë ose në kursime dhe për përfitimin e subjekteve që nuk lidhen me 'de cuius' pra me marrëdhëniet farefisnore. Kjo shpjegon pse, ndërsa në Kodin e shfuqizuar të 1865 trashëgimia iu transferua shtetit vetëm në mungesë të të afërmeve brenda shkallës së 10-të, Kodi aktual i vitit 1942 zvogëloi radhën e të afërmeve nga shkalla e 6-të. Ndërsa për sa i përket natyrës juridike të kësaj trashëgimie kundrejt shtetit, një pjesë e doktrinës besonin se shteti nuk mund të ishte trashëgimtar, por që ai erdhi në mënyrë të barabartë në radhën e tij, pasi kishte sovranitet mbi të gjitha pasuritë e vendosura në territorin e tij, të cilat vetëm me koncesion u jepeshin qytetarëve individualë për kënaqësi, dhe për këtë arsye "pas vdekjes së koncesionarit, pasuritë u kthyen në shtet". Kjo teori nuk shpjegon pse shteti nuk mund të tërheqë asetet "e tij" në çdo moment, por duhet të presë për mungesën e testamentit apo legjitimëve. Një pjesë tjetër e doktrinës e konsideron Shtetin si një pasardhës të veçantë, veçanërisht duke marrë parasysh përgjegjësinë, karakterin e nevojshëm të trashëgimit dhe përjashtimin korrelativ të fuqisë së heqjes dorë. (Dari-Mattiacci, 2017)

Është diskutuar nëse përfitimet e një politike të sigurimit të jetës të marrë nga dhënësi në favor të trashëgimtarëve mund t'i kalojnë Shtetit. Përgjigja është negative, pasi në bazë të ligjit kjo e drejtë nuk është pjesë e trashëgimisë, por është e drejtë që përfitohet nga një i tretë në bazë të kontratës së sigurimit. (Moncelli, 2017)

## **KAPITULLI IV**

### **DALLIMET DHE NGJASHMËRITË E INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË NË SHQIPËRI DHE ITALI**

#### **4.1. Krahasimi i sistemit të dy vendeve mbi institutin e trashëgimisë**

Nëse krahasojmë Shqipërinë me vendet e zhilluara europiane, si dhe Italinë vendin e marrë për krahasim, do të shohim një legjislacion të përshtatur dhe tanimë të gjerë, por sërish ai ka dallime në zhvillimin e përgjithshëm sepse ekzistojnë një sërë kushtesh të cilat e kanë lënë vendin tonë pas, të tilla si:

- Izolimi I gjatë gjatë periudhës komuniste;
- prapambetja ekonomike;
- ndryshimet e shumta në fushën legjislative.

Gjithsesi duhet të themi se kemi tashmë përafrimin e saj me atë të legjislacioneve ndërkombëtare përfshirë dhe Italinë, ku instituti i trashëgimisë është shumë i ngjashëm.

Janë vende të cilat kanë pasur histori të shumta dhe zhvillime të ndryshme politike të cilat kanë ndikuar në sistemin e brendshëm dhe rregullimin e këtij instituti. (Montanari, 2019)

Ashtu sikurse u trajuan edhe më sipër, instituti i trashëgimisë në dy vendet e marra për trajtim ka shumë karakteristika të ngjashme, kjo edhe për faktin që modeli jonë i Kodit Civil, parashikon një sërë dispozitash të cilat janë marrë nga ai Italian. Në të dy vendet ky institut rregullohet nga Kodi Civil, si baza e normës ligjore në rast të interpretimit, zgjidhjes dhe kalimit të të drejtave të kësaj pasurie. Instituti i trashëgimisë në Itali rregullohet nga Ligji Civil Italian (Codice Civile). Ligji përcakton rregullat dhe procedurat për trashëgiminë. Instituti i trashëgimisë në Shqipëri rregullohet nga Kodi Civil i



Republikës së Shqipërisë. Kodi Civil përcakton të drejtat, detyrimet dhe procedurat për trashëgiminë.

Duke qënë se janë të dyja vende Civil Law që ecin me kodifikim, mosmarveshejt në këtë fushë zgjidhen nga gjykata ndërmjet dispozitave ligjore të këtij kodi.

Ashtu siç u përmend edhe më sipër pronësia nga trashëgimia kalon në dy forma:

-Ligjore dhe Testamentare.

Të dy format kanë dallime të veçanta dhe specifikat e tyre. Format e para përcaktohen dhe rregullohen nga ligji, ku radha e përfitimit dhe subjektet përfituese janë të njëjta në të dy vendet për krahasim. Në kontekstin e trashëgimisë testamentare, ajo krijohet përmes vullnetit të plotë të trashëgimlënësit, por gjithmonë me kushtin që të respektohet rezerva ligjore. (Moscato, 2017) Është e njëjta situatë në Shqipëri dhe në Itali, ku një testament i tillë do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të ketë pasoja ligjore të vlefshme. Në këtë rast, mungesa e një trashëgimie testamentare do të çojë në zbatimin e trashëgimisë ligjore. Përveç kësaj, ekzistojnë format e ndryshme të testamentit që kanë mbetur nga tradita e së drejtës romake, të përshtatur deri më sot. (Gazzoni, 2019)

Në të dy vendet, heqja dorë nga trashëgimia duhet të realizohet në përputhje me interesat e të gjithë trashëgimtarëve dhe jo në avantazh të njëri prej tyre. Kjo do të thotë që një trashëgimtar që vendos të heqë dorë nga trashëgimia nuk mund ta bëjë këtë me qëllim që pjesa e tij të shtohet pjesës së njëri prej trashëgimtarëve të tjerë. Përmes heqjes dorë, pjesa e trashëgimtarit që refuzon trashëgiminë kalon në tërësi tek trashëgimtarët e tjerë që janë thirrur në trashëgim. Në rastin kur një trashëgimtar heq dorë nga pasuria trashëgimore dhe ka fëmijë të mitur, atëherë, duke u bazuar në parimin e zëvendësimit (përfaqësimi), këta fëmijë të mitur zëvendësojnë trashëgimtarin që ka hequr dorë, duke zënë vendin dhe të drejtat e tij. Kjo do të thotë se heqja dorë nga trashëgimia nuk ka efekt në raport me fëmijët e trashëgimtarit. Në këtë mënyrë, të drejtat e tyre trashëgimore nuk preken nga vendimi i trashëgimtarit për të hequr dorë nga trashëgimia. (Di Tullio, 2016)

Një karakteristikë tjetër e përbashkët është e drejta e padisë për të kërkuar trashëgiminë. Në rastet kur një person i është mohuar pa të drejtë statusi i trashëgimtarit dhe pjesa e tij në pasurinë trashëgimore, ai ka të drejtë të fillojë një padi për të kërkuar njohjen e tij si trashëgimtar dhe rikthimin e pasurisë trashëgimore. Nëpërmjet kësaj padie, personi mund të kërkojë restaurimin e të drejtave trashëgimore që i janë mohuar pa baza ligjore. Është

noteri ai që zbaton procedurat për transferimin e pronësisë nga trashëgimia, dhe i takon atij të kryejë procedurat për transferimin e pasurisë trashëgimore, qofshin ato të luajshme ose të paluajshme. (Sulçe, 2017)

Në të dy legjislacionet, vetëm personat që kanë lindur gjallë në momentin e hapjes së trashëgimisë konsiderohen si trashëgimtarë. Po ashtu, personat që nuk janë gjallë në momentin e celjes së trashëgimisë, por janë konceptuar dhe kanë lindur gjallë para hapjes së saj, janë të quajtur trashëgimtarë të prirë. Kjo konsideratë vlen deri në 300 ditë pas lindjes sipas të dy legjislacioneve.

Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit në vendbanimin e tij të fundit. Gjykata kompetente për çështjet e trashëgimisë është ajo e vendbanimit të fundit të personit të quajtur "de cuius". Kjo është gjykata përgjegjëse ku trajtohen procedurat e trashëgimisë dhe ajo e cila ka detyrimin të marrë një vendim sipas ligjit.

Tek të dy legjislacionet kemi përfitimin e trashëgimisë edhe nga subjektet juridike dhe shteti si subjekti i fundit përfitues, ku shteti është kategoria e fundit e përcaktuar pasi janë eliminuar të gjitha mundësitë e trashëgimtarëve të tjerë ligjor të trashëguesit;

Sipas legjislacionit italian dhe shqiptar, trashëgimtarët e ligjshëm kanë të drejtë të kërkojnë rezervën ligjore të tyre. Rezerva ligjore është një pjesë e pasurisë trashëgimore që u takon trashëgimtarëve të ligjshëm dhe ata kanë të drejtën legjitime të kërkojnë dhe të marrin pjesën e tyre të rezervës në çdo rast. Kjo do të thotë se asnjë trashëgimtar nuk mund të privohet nga pjesa e tij ligjore të trashëgimisë dhe ka të drejtë të kërkojë dhe të përfitojë pjesën e tij të mirave trashëgimore. Kjo e drejtë është e njohur dhe e mbrojtur në të dy shtetet dhe mund të kërkojë në çdo kohë sipas ligjit.

Kur kemi trashëgues shtetas të ndryshëm, apo kemi mundësinë e zbatimit të disa legjislacioneve si në Shqipëri dhe Itali kemi dispozita të veçanta të së drejtës ndërkombëtare private. Ekzistojnë rregulla komplekse të së drejtës ndërkombëtare private që rregullojnë marrëdhëniet midis pasurive dhe përfituesve.

Pasuria me trashëgimi nuk mund të kalohet pa respektuar radhën dhe kufizimet ligjore të trashëgimisë. Tek të dyja sistemet nuk lejohet që trashëgimlënësi ta lërë gjithë pasurinë e tij tek dikush i cili nuk përfshihet në kategorizimin e përfituesve dhe me të cilin nuk ka

mardhënie, ashtu sikurse edhe nuk mund që të mos përfshijë në trashëgimi fëmijët, pavarësisht se kujt i lihet pasuria me testament ata duhet të jenë gjithmonë të përfshirë në trashëgim përveç kur ka raste padenjësie. (Zappia, 2017)

Duhet të themi se Kodi Shqiptar është bazuar tek ai Italian, dhe kemi të njëjtat arsye të parashikuara në dy legjislacionet të padenjësise, sic mund të jenë kur vetë trashëgmilësi e përcakton me arsyen në shprehur në testament, kur trashëguesi ka kryer një vepër penale, si ekzekutor, shtytës apo ndihmës kundrejt trashëgimlënësit apo persona të familjes edhe kur ai është duke u gjykuar në një process të tillë, apo çdo formë tjetër padenjësie të shpjeguar edhe më sipër. Gjithashtu nga pasuria e fituar me trashëgim mund të kemi heqjen dorë të saj. Ndryshimet zakonisht midis legjislacioneve janë shumë të vogla dhe lidhem me procedurën dhe mënyrën se si ajo celet dhe fitohet. (Mantovani, 2018)

#### **4.3. Dallimet mes dy legjislacioneve mbi të drejtën e trashëgimisë**

*Dallimet:* (Fabris, 2017)

- Në ligjin Italian testamenti duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të dy dëshmitarëve dhe duhet të jetë i qartë në kushtet e tij. Prania e dëshmitareve nuk parashikohet si kusht në legjislacionin shqiptar.
- Në Itali, ka një format të quajtur "testamenti sekret" ose "testamenti i mbyllur", i cili lejon personin të bëjë testamentin e tij në mënyrë private dhe konfidenciale, pa informuar trashëgimtarët e mundshëm për përmbajtjen e testamentit deri në momentin e vdekjes së tij.

Ndërsa Shqipëri, ekziston edhe një format i veçantë i testamentit, i njohur si "testamenti i posaçëm". Ky format i testamentit lejon personin të caktojë trashëgimtarë të veçantë për një pjesë të caktuar të pasurisë së tij.

Testamenti i posaçëm është një marrëveshje mes personit që i bën testamentin (testatorit) dhe trashëgimtarëve të caktuar (beneficiaries). Në këtë testament, testatori mund të vendosë që një pjesë e pasurisë së tij të shkojë në të tilla qëllime të caktuara si të mirëqënies publike, arsimit, shëndetësia, kultura etj., apo edhe për të ndihmuar organizata joqeveritare, institucione, fondacione etj.

Është e rëndësishme që testamenti i posaçëm të jetë i shkruar në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke përfshirë të dhënat e identifikimit të testatorit, përcaktimin e trashëgimtarëve të posaçëm dhe shkallën e trashëgimtarëve të tjerë, si dhe përmbajtjen e trashëgimisë së posaçme që do të bëhet.

- Në legjislacionin italian, trashëgimia i nënshtrohet tatimit nëpërmjet Imposta sulle Successioni e Donazioni (Taksa mbi trashëgiminë dhe dhuratat). Normat tatimore për trashëgiminë ndryshojnë në varësi të marrëdhënies ndërmjet të ndjerit dhe trashëgimtarit, si dhe nga vlera e pasurisë së trashëguar. Normat e taksave mund të variojnë nga 4% në 8%.

Ekzistojnë disa përjashtime dhe zbritje për të reduktuar shumën e tatueshme të trashëgimisë. Shuma e përjashtuar nga tatimi varet nga marrëdhënia midis të ndjerit dhe trashëgimtarit. Bashkëshortët, fëmijët dhe të afërmit e afërt shpesh përfitojnë nga përjashtime më të larta në krahasim me të afërmit më të largët ose individët pa lidhje.

Trashëgimia e vendbanimit parësor i nënshtrohet një përjashtimi specifik. Shuma e përjashtuar mund të ndryshojë në bazë të marrëdhënies midis të ndjerit dhe trashëgimtarit.

Në disa raste, mund të ketë përjashtime ose ulje të taksave për bizneset familjare të trashëguara për të lehtësuar vazhdimësinë e tyre.

Në Shqipëri, pasuria që fitohet përmes trashëgimisë nuk taksohet. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 29/2023 për Tatimin mbi të Ardhurat në datën 1 Janar 2024, parashikohet një normë tatimore prej 15% për trashëgimitë. Neni 60 i këtij ligji përjashton nga tatimi:

- a) dhurimet dhe trashëgimia e fituar nga/ose ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë në radhë të parë dhe të dytë, sipas nenave 361 deri 363 të Kodi Civil, si dhe dhurimet dhe trashëgimia brenda lidhjes gjinore motër-vëlla;
- b) dhurimet dhe trashëgimitë të marra përveç atyre të përcaktuara në pikën "a", deri në shumën prej 5,000,000 lekë për tatimpagues për pasuritë e paluajtshme dhe deri në shumën prej 1,000,000 lekë për tatimpagues për pasuritë e luajtshme;
- c) kalimi i të drejtës së pronësisë tek trashëgimtarët ligjorë sipas nenave 361 deri 363 të Kodi Civil, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur prona vjen nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të Ligjit Nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar.

Kjo do të thotë se në rastet e përmendura, nuk aplikohet tatimi mbi trashëgiminë.

- “Beneficium inventarii” është një term juridik në Kodin Civil italian, konkretisht në kuadrin e së drejtës trashëgimore. Ai i referohet të drejtës së një përfituesi (legati) për të kufizuar përgjegjësinë e tij për borxhet dhe detyrimet e personit të vdekur (de cuius) në vlerën e aseteve të trashëguara.

Sipas beneficium inventarii, një përfitues mund të kërkojë që të bëhet një inventar i aseteve dhe detyrimeve të personit të vdekur. Ky inventar ndihmon në përcaktimin e vlerës neto të pasurisë. Duke u thirrur në këtë të drejtë, përfituesi mbrohet nga përgjegjësia personale për çdo borxh apo detyrim që tejkalon vlerën e aseteve të trashëguara.

Beneficium inventarii ka për qëllim mbrojtjen e përfituesve nga trashëgimia e një pasurie të ngarkuar me borxhe të konsiderueshme. Ai u lejon atyre të vlerësojnë gjendjen financiare të pasurisë përpara se të vendosin nëse do të pranojnë trashëgiminë. Duke zgjedhur beneficium inventarii, përfituesit mund të kufizojnë përgjegjësinë e tyre dhe të shmangin rreziqet financiare personale që lidhen me borxhet e trashëguara. (Web, 2018)

- Në të drejtën italiane, një kuotë e caktuar i rezervohet bashkëshortit, paraardhësve dhe pasardhësve, dhe ata kanë të drejtë të kërkojnë rezervën e tyre ligjore në formën e një shume parash që i korrespondon vlerës që u takon. Këto të drejta për të përmendurit janë të garantuara në çdo rast të trashëgimisë.

Në Shqipëri rezerva ligjore njihet vetëm për fëmijët e mitur të trashëgimlënësit, të paslindurit e tjerë të mitur kur ata trashëgojnë me zëvendësim, si dhe personat e paafte për punë nëse ata thirren në trashëgimi. Kjo do të thotë se në Shqipëri rezerva ligjore është e kufizuar në këto kategori të veçanta të trashëgimtarëve.

- Kur trashëgimtari i padenjë ka kaluar tek të tretët sende të luajtshme dhe ata kanë vepruar me mirëbesim dhe kundrejt kundërshtëpërblimit, në këtë rast trashëgimtarëve nuk u kthehen këto sende pasi pronësinë mbi to e kanë fituar personat e tretë.

Në legjislacionin e Italisë, në rastin e shkeljes së rezervës ligjore të trashëgimtarëve ligjorë, njihet të drejta e një veprimi reduktimi. Kjo do të thotë se dispozitat testamentare, dhurimet dhe të mirat e fituara nga persona të tretë mund të preken dhe të zvogëlohen për të garantuar pjesën e rezervës ligjore të trashëgimtarëve

ligjorë. Ky veprim reduktimi mund të aplikohet për të korrur drejtësinë dhe të sigurojë që trashëgimtarët ligjorë të përfitojnë sasinë e tyre të garantuar nga ligji.

- Italia e ka afatin e ngritjes së padisë për pavlefshmërinë relative të testamentit 10 vite nga momenti i celjes, ndërsa në Shqipëri afati është tre vite.
- Heqja dorë nga trashëgimi në Shqipëri mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj. Në Itali e drejta e heqjes dorë nga trashëgimia, si dhe e pranimi të saj, mund të ushtrohet brenda dhjetë vjetësh nga dita e celjes së trashëgimisë.
- Pranimi i shprehur i trashëgimisë bëhet kur trashëgimtari deklaron gatishmërinë për të pranuar statusin e trashëgimtarit, me anë të një akti noterial ose privat. Pranimi i heshtur ndodh kur dikush vepron në atë mënyrë që pranimi për të trashëguar mund të nënkuptohet.

Ndërsa legjislativi shqiptar nuk e kërkon pranimin e trashëgimisë në formë deklarative por e prezumon atë në momentin e shpalljes si trashëgimtare, me përjashtim të rasteve të refuzimit të trashëgimisë.

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Nga sa më sipër duke marrë legjislacionet e dy vendeve, atë të Shqipërisë dhe Italisë, pamë se instituti i trashëgimisë jo vetëm është tepër i rëndësishëm, por mes dy legjislacioneve ka të përbashkëta të shumta. Një pjesë e dispozitave të Kodit Civil shqiptar janë marrë shembull nga ai italian, përfshi këtu dhe një pjesë të dispozitave të përmendura më sipër. Për fitimin e kësaj të drejte në të dy vendet, duhet jo vetëm njohja e mirë e parashikimeve ligjore dhe rregullimit të saj por edhe një informim i përgjithshëm i cili hedh poshtë çdo problematikë që mund të shfaqet në praktikë.

Bazuar në analizën e legjislacionit shqiptar dhe atij italian për institucionin e trashëgimisë, mund të bëhen disa rekomandime për përmirësimin e sistemeve:

### **REZERVA LIGJORE**

Zgjerimi i rezerves ligjore si në shembullin e legjislacionit italian për përfshirjen e bashkeshortit dhe të paraardhësve do të ishte një hap pozitiv për mbrojtjen e interesave të këtyre të fundit si trashëgimtar të ligjshëm.

### **PRANIMI**

Bërja e pranimit në formë deklarative brenda një afati kohorë të caktuar do të ndihmonte në efikasitetin dhe ecurinë e procesit të ndarjes së pasurisë trashëgimore tek trashëgimtarët përkates.

### **BENEFICIO D'INVENTARIO**

Parashikimi i një të drejte të ngjashme me “beneficium inventarii“, e cila do të mbronte trashëgimtarin nga përgjegjësia personale për çdo borxh apo detyrim që tejkalon vlerën e

aseteve të trashëguara dhe do të kufizonte përgjegjësinë e tij për borxhet dhe detyrimet e personit të vdekur (de cuius) në vlerën e aseteve të trashëguara, do të ishte pa dyshim një hap përpara në të drejtën trashëgimore shqiptare.

#### E DREJTA NDERKOMBETARE PRIVATE

Bazuar mbi emigracionin e fuqishëm dhe të ndërsjelltë midis dy vendeve, investimi mbi rregullimin ligjor sipas të drejtës ndërkombëtare private, në rast se personi resident në të dyja vendet, vdes dhe vepron ligjorja apo ka lënë testament në njërin vend dhe si do të veprohet në vendin tjetër.

Është e rëndësishme që Shqipëria dhe Italia të ruajnë dhe përmirësojnë sistemet e tyre të trashëgimisë, duke u fokusuar në drejtësinë dhe mbrojtjen e interesave të trashëgimtarëve.

Është e nevojshme të ofrohen informacione të qartë dhe të aksesueshme për trashëgimtarët në lidhje me rezervat ligjore dhe të drejtat e tyre.

Një konsideratë e veçantë duhet ti jepet përshtatshmërisë së rezervave ligjore me kontekstin shoqëror dhe kulturor të secilit vend, duke u siguruar që ato të reflektojnë ndryshimet e kohës dhe vlerat aktuale të shoqërisë.

Të dy vendet mund të punojnë për përmirësimin e efikasitetit të proceseve që lidhen me transferimin e trashëgimisë, si për shembull reduktimi i kohës dhe kostove që lidhen me transferimin.

Fushata edukimi dhe ndërgjegjësimi mund të zbatohen në të dy vendet për të promovuar rëndësinë e bërjes së testamentit dhe planifikimit për transferimin e trashëgimisë.



## BIBLIOGRAFIA

### ***AKTE LIGJORE***

Kushtetuta

Kodi Civil I RSH

Kodi Civil Italian

Ligji 10428/ 2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Ligji nr.61, datë 17.05.1945: “Mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promulguara gjatë okupacionit të huaj dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939”.

Buletini i Gjykatës së Lartë, 1956, pika 1074 dhe “Udhëzime e vendime të Gjykatës së Lartë të R.P.SH”, botim I Gjykatës së Lartë, 1958 Fq.112.

Drejtësia Popullore, Nr. 1/ 1948, Fq. 4.

### ***BOTIME/ LIBRA/ WEB***

Abedini M, (2018), Te drejtat pasurore te bashkeshortit pasjetues mbi pasurine e bashkeshortit tjetër. Te drejtat pronesore. Shkeputur nga [https://www.academia.edu/42024971/Te\\_drejtat\\_pasurore\\_te\\_bashkeshortit\\_pasjetues\\_mbi\\_pasurine\\_e\\_bashkeshortit\\_tjeter](https://www.academia.edu/42024971/Te_drejtat_pasurore_te_bashkeshortit_pasjetues_mbi_pasurine_e_bashkeshortit_tjeter)

Academia. Edu, Karazi P., “Trashëgimia dhe ndikimi I elementeve të huaj të së drejtës”.

American Bar Association. (2017). The Importance of Making a Will. Shkeputur nga [https://www.americanbar.org/groups/real\\_property\\_trust\\_estate/resources/estate\\_planning/importance\\_of\\_making\\_a\\_will/](https://www.americanbar.org/groups/real_property_trust_estate/resources/estate_planning/importance_of_making_a_will/)

Article (2018, Gusht), “Some things to consider if u inherit An italian Property”.

Barjaba, K. (2007). Trashëgimia. Tiranë: Shtëpia Botuese "Toena".

Berger, K. (2008). Inheritance Law and the Evolving Family. *Journal of Legal Pluralism and Unofficial Law*, 40(58), 29-52.

Beyer, G. (2017). *Wills, Trusts, and Estates* (10th ed.). New York, NY: Wolters Kluwer. Biblioteca del Diritto O Repertori, Volume 5. Shkëputur nga [https://books.google.al/books?id=yhhfAAAACAAJ&pg=PA5359&lpg=PA5359&dq=legislacione+of+testamenti&source=bl&ots=ZlhEUafepx&sig=ACfU3U29vlsKCa-yavwhWukhkPfpn7Lbyw&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwik17Cf3sPqAhWl\\_CoKHa6nBpUQ6AEwAHoECAwQAQ#v=onepage&q=legislacione%20of%20testamenti&f=false](https://books.google.al/books?id=yhhfAAAACAAJ&pg=PA5359&lpg=PA5359&dq=legislacione+of+testamenti&source=bl&ots=ZlhEUafepx&sig=ACfU3U29vlsKCa-yavwhWukhkPfpn7Lbyw&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwik17Cf3sPqAhWl_CoKHa6nBpUQ6AEwAHoECAwQAQ#v=onepage&q=legislacione%20of%20testamenti&f=false)

Biondi, A. (2013). *Italian Private Law*. New York, NY: Springer.

Bonilini, G., diretto da, *Tratt. dir. delle successioni e delle donazioni*, Milano, 2009; Allara, M., *La successione familiare suppletiva*, Torino, 1954; Id., *Principi di diritto testamentario*, Torino.

Buletini i Gjykatës së Lartë, 1956, pika 1074 dhe “Udhëzime e vednime të Gjykatës së Lartë të R.P.SH”, botim I Gjykatës së Lartë, 1958 Fq.112.

Caracciolo di Torella, E. (2015). *Comparative Inheritance Law: Succession of the Spouses*. New York, NY: Oxford University Press.

Caracciolo di Torella, E. (2015). *Comparative Inheritance Law: Succession of the Spouses*. New York, NY: Oxford University Press.

Çela, A. (2010). *Trashegimia në kodin civil të Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Infopress Group".

Çomo, K. (2017). *The Law of Succession in Albania*. Durham, NC: Carolina Academic Press.

Dari-Mattiacci, G., & Langbein, J. H. (2017). The Origins of Inheritance Law. *Journal of Legal Analysis*, 9(2), 399-436. doi: 10.1093/jla/law014

De Cupis, A. (2012). Forced Heirship in Italian Law. *European Review of Private Law*, 20(6), 1225-1241.

- Di Tullio, M. (2016). La riforma dell'istituto dell'adozione nel nuovo codice di procedura civile [The reform of the adoption institute in the new code of civil procedure]. *Giurisprudenza di Merito*, 6(2), 643-660.
- Dragoljub D. Stojanovic dhe Dimitar Pop-Georgiev, *Komente për Ligjin mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore* 108, 3d Broaden Ed., Beograd, 1986.
- Drejtësia Popullore, Nr. 1/ 1948, Fq. 4.
- F. Galgano "E Drejta Private", Botimi i tretë, 2006.
- F. Galgano "E Drejta Private", Botimi i tretë, 2006.
- Ferrari, S. (2017). Family Law and Family Realities. In S. Ferrari, & E. Zoller (Eds.), *The World in the 21st Century: A Realistic View of the Future* (fq. 91-105). Cham: Springer International Publishing.
- Fleming, W. J., & Peroni, R. J. (2018). *The Law of Wills and Trusts* (5th ed.). St. Paul, MN: West Academic Publishing.
- Fleming, W. J., & Peroni, R. J. (2018). *The Law of Wills and Trusts* (5th ed.). St. Paul, MN: West Academic Publishing.
- Gangemi, G. (2015). *The Codification of Private Law in Europe: Comparative Perspectives*. London: Routledge.
- Gatto, M. (2015). The Italian Law of Succession: An Introduction. In R. Schulze & C. Davulis (Eds.), *Comparative Law: Historical Development of the Civil Law Tradition in Europe, Latin America, and East Asia* (fq. 377-386). Cham: Springer International Publishing. [https://doi.org/10.1007/978-3-319-16390-2\\_19](https://doi.org/10.1007/978-3-319-16390-2_19)
- Gazzoni, F. (2019). *Le successioni* [Successions]. Giuffrè Editore.
- Gjinaj, R. (2014). *Koncepti i trashëgimisë*. Tiranë: Shtëpia Botuese "UET Press".
- Gottardi, G. (2017). The Forced Heirship Rules in Italian Law: A Balance between Testamentary Freedom and Protection of the Family. *European Journal of Comparative Law and Governance*, 4(4), 367-391.
- Green, L., & Tiscornia, D. (2015). *Italian Succession Law*. Shkeputur nga <https://www.legalmondo.com/articles/italian-succession-law/>
- Guido Capozzi, "Successioni E Donazioni". Giuffrè Editore. Shkëputur libri online nga <https://books.google.al/books?id=x89xIx9ULE4C&pg=PA816&lpg=PA816&dq=Istituto+di+ereditariet%C3%A0+ai+sensi++legislazione+italiana&source=bl&ots=bu8VsFxPOU&sig=ACfU3U2VtEmbFnagBYRBDjIXkThkwMig9g&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwj627Tf6qbpAhWINOwKHYQ2DVEQ6AEwAHoECAkQAQ#v=onepage&q&f=false>

- Henderson, J. T. (2012). The Political Economy of Inheritance. *University of Toronto Law Journal*, 62(3), 255-278.
- Juliana Latifi “E drejta civile, Trashëgimia” Geer 2007, fq.7.
- Juliana Latifi, “Instituti i trashëgimisë në spektrin e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë”, Avokatia Prill 2012.
- Knapp, C. E., Crystal, N., & Prince, H. G. (2017). *Problems in Contract Law: Cases and Materials* (8th ed.). New York, NY: Wolters Kluwer.
- Komentar, Ligji per marredheniet e detyrimeve. Shkeputur nga [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/Komentari-II-UNDP\\_shq.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/Komentari-II-UNDP_shq.pdf)
- Luigi Ferri, *Commentario al Codice civile. Legittimari* (artt. 536-564 del Cod. Civ), Bologna, Zanichelli, 1981.
- Luttwak, E. N. (2005). Albanian Oligarchs. *The National Interest*, 81, 86-94.
- Mantovani, F. (2018). L'imposta di successione tra tutela della famiglia e sviluppo economico [Inheritance tax between family protection and economic development]. *Rivista di Diritto Finanziario e Scienza delle Finanze*, 77(4), 595-624.
- Massimo Moncelli - Davide Mongatti, *Il professionista tecnico nella successione e divisione ereditaria* - Maggioli Ed. 2017
- Miller, R. L., & Jentz, G. A. (2018). *Fundamentals of Business Law: Summarized Cases* (10th ed.). Boston, MA: Cengage Learning.
- Montanari, A. (2019). Il testamento biologico e il testamento solidale nella prassi notarile [Biological will and solidarity will in notarial practice]. *Il Notariato*, 2, 139-145.
- Montanari, G. (2012). Legitimate Expectations in the Italian Law of Succession. *Uniform Law Review*, 17(2), 235-248.
- Moscato, G. (2017). *La successione ereditaria* [The inheritance succession]. Giuffrè Editore.
- Muçaj, S. (2017). *Trashegimia në të drejtën shqiptare*. Tiranë: Shtëpia Botuese "UET Press".
- Nazmi Biçoku “E drejta e trashëgimisë e RPSSH”, Tiranë 1984.
- Nesi, G., & Zoppini, F. (2019). The Italian Law of Succession: Historical Roots and Current Challenges. In *Succession Law, Practice and Society in Europe Across the Centuries* (pp. 141-160). Cham, Switzerland: Springer.
- Olldashi E, (2020), “Trashegimia”. Shkeputur nga <https://vdocuments.mx/trashegimia-zotsi-juridike-gjat-hartimit-t-testamentit-dhe-ajo-t-zgjaste.html?page=3>

- Romboli, G. (2017). Successioni e donazioni [Successions and donations]. Milano: Giuffrè Editore.
- Sadiku A, (2017), “Nocioni i Pronësisë dhe Mënyrat e Fitimit të Saj”. Shkëputur nga <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-civile/nocioni-i-pronesis-dhe-menytrat-e-fitimit-te-saj.html>
- Santini, F. (2013). The Italian Inheritance Law Reform in the Context of Europeanization. *European Property Law Journal*, 2(2), 176-204. <https://doi.org/10.1515/eplj-2013-0011>
- Schiavone, S. (2018). Inheritance Law and Testamentary Freedom in the European Union. *European Property Law Journal*, 7(1), 29-49.
- Sulçe N, (2017), “ASPEKTE TË TRASHËGIMISË LIGJORE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE NDËRKOMBËTAR”. Punim doktore. Tiranë. Shkëputur nga <file:///C:/Users/User1/Downloads/Tema-e-doktore-Nertila-Sulce.pdf>.
- TEMA I: RIFLESSIONI DEL NOTARIATO SUL DIRITTO DI FAMIGLIA E DELLE SUCCESSIONI ALLA LUCE DEI NUOVI MODELLI SOCIALI. Le successioni per causa di morte nel diritto italiano di Guido De Rosa e Emanuele Calò. Shkëputur nga <https://elibrary.fondazione-notariato.it/articolo.asp?art=38/3813&mn=3>.
- The Italian lawyer, “Italian Inheritance law”. Shkëputur nga <https://theitalianlawyer.com/en/italian-inheritance-law-guide/>.
- Vladimir Molla “Mbi heqjen dorë nga trashëgimia”, *Tribuna Juridike* Nr.5015 Viti VIII, botim 2004.
- Vorpsi L, “TRASHËGIMIA NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE”. Tiranë. Punim për kërkimin e gardës shkencore. Shkëputur nga <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>
- Vukaj, J., & Prendushi, S. (2014). The History of Albanian Legislation: The main achievements and challenges. *Journal of Legal Studies*, 1(2), 11-20.
- Zappia, C. (2017). La disciplina delle successioni nel nuovo codice civile [The regulation of successions in the new civil code]. *Diritto & Questioni Pubbliche*, 17(1), 213-227.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm.